

UNIVERSITETI I GJILANIT “KADRI ZEKA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

**PROGRAMI MASTER: MËSIMDHËNIA DHE KURRIKULA NË ARSIMIN
FILLOR**



TEZA MASTER

Aplikimi i metodave të mësimdhënies në zhvillimin e aftësive komunikuese
dhe të menduarit kritik në arsimin fillor

Mentore:

Prof. Asoc.Dr. Nerxhivane Krasniqi

Kandidatja:

Egzona Rrustemi

Gjilan, 2025

UNIVERSITETI I GJILANIT “KADRI ZEKA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

**PROGRAMI MASTER: MËSIMDHËNIA DHE KURRIKULA NË ARSIMIN
FILLOR**



PUNIM DIPLOME

Titulli i punimit:	Aplikimi i metodave të mësimdhënies në zhvillimin e aftësive komunikuese dhe të menduarit kritik në arsimin fillor.
Emri dhe mbiemri:	Egzona Rustemi
Statusi i studentit:	I rregullt
Numri i amzës (ID Regjistri):	23151010
Niveli i studimeve:	MASTER
Departamenti:	Mësimdhënie dhe Kurrikula në Programin Fillor
Programi:	Mësimdhënie dhe Kurrikula në Programin Fillor
Mentori i punimit:	Prof.Asoc.Dr. Nerxhivane Krasniqi

Deklaratë e autorit mbi origjinalitetin e punimit

Duke ditur përkufizimin dhe format e plagjiaturës në botën akademike, deklaroj se punimi im nuk cenon të drejtën e autorit të askujt.

Unë deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë, se punimi është origjinal i kryer personalisht nga unë. Ky punim, apo pjesë të tij, nuk janë prezantuar dhe botuar më parë nga ndonjë institucion tjetër.

Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara sipas standardeve të praktikave referuese.

Author's statement on the originality of the work

Knoçing the definition and forms of plagiarism in academia, I declare that my work does not infringe anyone's copyright.

I declare under my full responsibility, that the work is original done personally by me. This paper, or parts of it, have not been previously presented and published by any other institution. The paper does not contain material written by any other person, except in cases cited and referred to according to the standards of reference practices.

Emri/Name:

Nënshkrimi/Signature:

Data/Date:

Egzona Rustemi

FALËNDERIM

Të punosh tezën e masterit duhet përpjekje, përkushtim dhe angazhim e që nuk do të ishte aspak e lehtë pa mbështetjen dhe përkrahjen e të gjithë atyre që më rrethojnë e që kontribuan në mënyra të ndryshme në realizim e këtij projekti.

Falënderime të veçanta i dedikohen mentores sime Prof.Asoc.Dr. Nerxhivane Krasniqi për udhëzimet profesionale, sygjerimet dhe këshillat shumë të rëndësishme për mua, për durimin, gatishmërinë e bashkëpunimit dhe mbikqyrjen gjatë çdo faze të këtij procesi hulumtues, të cilën e konsideroj kyçe në cilësinë e këtij punimi.

Falënderime dhe mirënjohje të sinqertë për të gjithë pjesëmarrësit, që ndanë kohën, u angazhuan, reflektuan dhe ndanë përvojat e tyre duke më dhënë mundësinë e realizimit të këtij punimi shkencor.

PËRMBAJTJA

ABSTRAKTI	6
Lista e tabelave	8
Lista e figurave	8
I. HYRJE	9
II. KAPITULLI I	10
2.1 Ndikimi i mësimdhënies bashkëkohore në zhvillimin e nxënësëve	10
2.2 Metodatat bashkëkohore e të mësuarit në zhvillimin e nxënësëve	11
2.3 Zhvillimi i shkathtësisë së komunikimit - komunikues efektiv	13
2.4 Pse aftësitë e komunikimit janë të rëndësishme për nxënësit?.....	14
2.5 Realizmi i aktiviteteve, roli dhe funksioni i tyre në zhvillimin e aftësive të komunikimit....	15
III. KAPITULLI II	16
3.1 Cka është mendimi kritik ?.....	16
3.2 Rëndësia e mendimit kritik në shkollë	18
3.3 Mjedis i mësimor nxitës për zhvillimin e komunikimit dhe mendimit kritik	19
3.4 Aplikimi i metodave për nxitjen e të menduarit kritik.....	21
3.4.1 Metoda e diskutimit (bashkëbiseduese).....	23
3.4.2 Metoda e demonstrimit	24
3.4.3 Metoda e aktivitetit praktik	24
3.5 Struktura ERR dhe mendimi kritik.....	25
3.5.1 Përparësitë e strukturës ERR	27
3.6 Taksonomia e Bloom-it për zhvillimin e mendimit kritik.....	28
IV. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	28
4.1. Problemi i hulumtimit	31
4.2. Qëllimi i hulumtimit	31
4.3. Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat	32
4.4. Pjesëmarrësit dhe mostra	32
4.5. Procedurat e hulumtimit	33
4.6. Analiza e të dhënave	34

V. REZULTATET E HULUMTIMIT	35
5.1. Të dhënat demografike	36
5.2. Të dhënat sasiore	37
5.3 Të dhënat grafikore	46
5.4. Përfundimi	64
5.5. Rekomandimet	65
VI. REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE	66
6.1 SHTOJCA Pyetësor për mësimdhënës.....	68

Lista e grafikave dhe tabelave

Grafiku 1. Gjinia e mësimeve.....	48
Grafiku 2. Grupmosha e mësimeve.....	49
Grafiku 3. Përvoja e mësimeve.....	49
Grafiku 4. Niveli i shkollimit të mësimeve.....	50
Grafiku 5. Ndjekja e trajnimeve të mësimeve.....	50
Grafiku 6. Përfshirja e aktiviteteve në orë mësimore.....	51
Grafiku 7. Rezultatet e metodave mësimore për nxitjen e aftësive të buta	52
Grafiku 8. Rezultatet e metodës së bashkëpunimit	53
Grafiku 9. Arritjet e nxënësve në ndikimin e metodave të mësimdhënies	54
Grafiku 10. Rezultatet e metodës së dialogut	55
Grafiku 11. Kushtet infrastrukturore të shkollës.....	56
Grafiku 12. Informata kthyesë e mësimeve ndaj për nxënësit.....	57
Grafiku 13. Identifikimi vështirësive gjatë aplikimit të metodave të mësimdhënies.....	58
Grafiku 14. Qartësimi i ideve të nxënësit në ndikimin e metodave mësimore	59
Grafiku 15. Rezultatet e metodës demonstrative	60
Grafiku 16. Ndikimi shkathhtësive të komunikimit të nxënësit	61
Grafiku 17. Ndikimi i shprehjeve komunikuese gjatë të nxënësit	62
Grafiku 18. Ndikimi i parashtrimit të pyetjeve.	63
Grafiku 19. Nxitja e parashtrimit të pyetjeve.....	64
Grafiku 20. Ndikimi i metodës së demonstrimit.....	65
Table 1 Llojet e pyetjeve sipas Taksonomisë së Bloom.....	31
Table 2 Të dhënat demografike të mësimeve.....	38
Table 3 Analiza përshkruese (frekuenca, përqindja, mesatarja aritmetike, moda dhe devijimi standard) e të dhënave nga mësimeve.....	41

ABSTRAKTI

Në këtë temë masteri do të trajtoj temën **“Aplikimi i metodave të mësimdhënies në zhvillimin e aftësive komunikuese dhe të menduarit kritik në arsimin fillor ”**

Tema synon të nxjerrë përfundime lidhur me ndikimin e aplikimit të metodave mësimore në zhvillimin e shkathtësive të buta (komunikimit dhe mendimit kritik) tek nxënësit, dhe të informohemi në praktikë nga mësimdhënësit sa i aplikojnë këto metoda dhe cilat janë qëndrimet e tyre për ndikimin e këtyre metodave mësimore për zhvillimin e shkathtësive të buta të nxënësit e tyre.

Pjesëmarrës në këtë hulumtim ishin 40 mësimdhënës të shkollave fillore publike të komunës së Ferizajt, përkatësisht SHFMU “Vëllëzërit Jashari”, SHFMU “Gjon Sereqi”, SHFMU “Tefik Canka” dhe SHFMU “Jeronim De Rada”.

Instrument të hulumtimit kam shfrytëzuar pyetësoin e përbërë nga dy pjesë, pjesa e parë përbëhet nga 5 pyetje për të dhënat demografike për mësimdhënësit, dhe pjesa e dytë nga 15 pyetje për tematikën e temës, prej të cilave kam mbledhur të dhëna për t’i vërtetuar ose hedhur poshtë hipotezat e ngritura për këtë temë.

Nga rezultatet e arritura vijmë në përfundim se aplikimi i metodave të mësimdhënies lehtësojnë mësimdhënien dhe nxënien, zhvillojnë mendimin kritik, nxisin dëshirën, përkushtimin, pjesëmarrjen aktive, të menduarit e nivelit të lartë.

Përpunimin e të dhënave e kam realizuar për metodës statistikore dhe asaj sasiore

Metodën statistikore e kemi përdorur për të gjetur numrin dhe përqindjen. Nga ato rezultate, kemi nxjerrë tabelat dhe grafikët e të dhënave statistikore të fituara në hulumtim, pastaj këto të dhëna janë analizuar me analizë tematike.

Përzgjedhja e mostrës është bërë përmes mostrës së rastësishme (të thjeshtë).

Fjalët kyçe: shkolla, zhvillim, aftësim, mendim kritik etj.

ABSTRACT

In this master's thesis, the topic will be "**Application of teaching methods in the development of communication skills and critical thinking in primary education**"

The topic aims to draw conclusions regarding the impact of the application of teaching methods on the development of soft skills (communication and critical thinking) in students, and to be informed by teachers about how much they apply these methods in practice and what their attitudes are about the impact of these teaching methods on the development of soft skills in their students.

Participants in this research were 40 teachers from public primary schools in the municipality of Ferizaj, namely SHFMU "Vëllëzërit Jashari", SHFMU "Gjon Sereqi", SHFMU "Tefik Canka" and SHFMU "Jeronim De Rada".

As a research instrument, I used a questionnaire consisting of two parts, the first part consisting of 5 questions for demographic data for teachers, and the second part of 15 questions about the topic of the topic, from which I collected data to confirm or refute the hypotheses raised for this topic.

In this research, conclusions were drawn that the application of teaching methods facilitate teaching and learning, develop critical thinking, encourage desire, commitment, active participation, high-level thinking.

I have processed the data using statistical and quantitative methods

We used the statistical method to find the number and percentage. From those results, we have extracted tables and graphs of the statistical data obtained in the research, then these data were analyzed with thematic analysis.

The sample selection was done through random (simple) sampling.

Keywords: school, development, training, critical thinking, etc.

HYRJE

Sfidat e ndryshme me të cilat po ballafaqohet sistemi ynë arsimor, tendenca për të arritur rezultate sa më të larta, më kanë nxitur që të përcaktohem për temën e përzgjedhur.

Duke e ditur që secili nxënës është unik, përmes metodologjisë së zgjedhur me shumë kujdes dhe teknikave mësimore ne do të mund të kuptojmë më qartë atë se çka është i aftë secili nxënës të bëjë. Aftësitë e komunikimit janë thelbësore në shkollën fillore, duke krijuar një bazë për mësim të suksesshëm dhe ndërveprim social.

Komunikimi efektiv nxit një ndjenjë të mirëkuptimit, duke u mundësuar nxënësit dhe mësuesit të ndërveprojnë në mënyrë të sigurt dhe të qartë.

Shkathtësitë dhe qasjet metodike për frymëzimin e nxënësve për pjesëmarrjeaktive në procesin e të nxënës dhe zhvillimit shkathtësive dhe vlerave janë të domosdoshme.

Zhvillimi apo formimi i këtyre shkathtësive të fëmijëve duhet të fillojë në familje, ndërsa forma institucionale, e organizuar dhe profesionale duhet të realizohet në shkollë.

Personi kryesor në shkollë, i thirrur që në mënyrë profesionale-pedagogjike të realizojë/arrijë zhvillimin e shkathtësisë së komunikimit dhe të mendimit kritik të nxënësit, është mësimpldhënësi.

Qasja dhe përkushtimi profesional-pedagogjik i mësimpldhënësit nënkupton zbatimin e metodologjive, teknikave, strategjive dhe materialeve të ndryshme dhe të përshtatshme për arritjen e qëllimit, objektivave dhe rezultateve mësimore.

Zhvillimi i shkathtësive bazë/të buta është një element i rëndësishëm i sigurimit/përmirësimit të qëndrueshëm të të mësuarit dhe suksesit për jetë dhe punë.

Komunikimi u jep gjithashtu mundësi nxënësve të pyesin për sqarime, të shqyrtojnë dhe të menduarit e vet, të ndjekin interes vetjake dhe të marrin përgjegjësi duke marrë role udhëheqëse në grup dhe duke u afirmuar më në qendër të klasës. (Steele, J & Meredith, K & Temple, C, 1998)

Kapitulli I

2.1 Ndikimi i mësimdhënies bashkëkohore në zhvillimin e nxënësve.

Zhvillimet e vrullshme në shoqërinë e sotme paraqesin një sfidë për mësimdhënësit që te përgatisin nxënësit e shekullit XXI. Të gjitha metodat, teknikat dhe strategjitë në metodologjinë e zhvillimit të mendimit kritik gjatë leximit dhe shkrimit bëjnë pjesë në metodologjinë ndërvepruese.

(Hyseni.H, Mita.N, Salihaj.J, & D, P, 2003)

(Grillo, 2002)shpjegon se mësimdhënia “është faktor kryesor në realizimin e mësimnxënies; është akti i të dhënit mësim në një institucion arsimor; është veprimtaria dhe drejtimi i procesit mësimor nga mësuesi”. Në mësimdhënien bashkëkohore përdoren strategji të ndryshme, por asnjëra nuk mund të jetë e përshtatshme për të gjithë nxënësit dhe të arrihen suksese të larta. Prandaj është e nevojshme të përzgjedhjen strategji të mësimdhënies dhe t’iu përshtaten nevojave e dallimeve në mes nxënësve të ndryshëm. (Fullan, 2001)

Në fillim të mësimi është e nevojshme që mësuesi të di se cilin lloj i të nxënit është i përshtatshëm për nxënësit e tij dhe pastaj, si ta zhvillojë mësimin, që të lehtësojë të nxënit. (Musai B. , Të menduarit kritik: Çfarë është dhe çfarë mund të jetë?, 2003, f. 80).

Mësimdhënësi ndryshon mënyrën e: mësimdhënies, planifikimit, menaxhimit të klasës, zbatimit të metodave mësimore. Ndërsa te nxënësi vërejmë këto ndryshime: aftësinë për të menduar në mënyrë kritike, përpjekja për të dhënë përfundime logjike, dëshira për të parashtruar pyetje, bashkëveprim në klasë, rritja e interesimit për të dhënë ide të reja. (Ismajli, 2012)

Mësimdhënia bashkëkohore nënkuptohet në shumë aspekte si; në strategji, metoda, teknika, forma, ndryshimin e rolit të mësimdhënësit dhe nxënësit, mjedisin shkollor, në respektimin e të drejtave të fëmijëve, në të kuptuarit dhe të menduarit ndryshe, në përcaktimin e objektivave, në vlerësim etj.” (Grup autorësh, 2005)

Mësimdhënësi përmes përdorimit të teknikave të mësimdhënies, do i jap përmasa të reja mësimi, duke nxitur mendimin kritik dhe të nxënit e pavarur dhe zgjidhjen e problemeve.

Sipas Asllan Vrapit (Vrapi, A., 2015) mësimdhënia me anë të zgjidhjes së problemeve zhvillon aftësitë për organizim dhe udhëheqje, zgjidhjen e problemeve, punë në grupe, komunikim, zbatim të njohurive, punë të pavarur dhe vetëorientim, përdorim të teknologjive informative dhe në fund por jo më pak e rëndësishme zhvillon të menduarit kritik dhe krijues.

2.2 Metodat bashkëkohore e të mësuarit në zhvillimin e nxënësve

Fjala "metodë" rrjedh nga gjuha greke (methodos), që do të thotë rrugë ose mënyrë me të cilat udhëhiqemi me rastin e realizimit të detyrave dhe veprimeve të punës.

Në punën mësimore, përdorimi i metodave shpie në realizimin e qëllimeve dhe detyrave edukative dhe arsimore, kurse ilësia e mësimit varet edhe nga metodat mësimore dhe nga zgjedhja e drejtë e tyre gjatë organizimit të procesit mësimor. (Rraçi, A & Kuqi, S, 2017)

Metodat kanë rëndësi të veçantë në teorinë dhe praktikën e punës mësimore, pasi që ato përcjellin tërë ecurinë e zhvillimit të procesit mësimorë.

Metodat e mësimdhënies janë mënyra të punës në mësimdhënie, edhe atë si të mësimdhënësit, ashtu edhe të nxënësit, ngase edhe mësimdhënësit edhe nxënësit janë aktiv gjatë mësimit.

(Sylejmani, 2012)

Përdorimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhës nxit veprimtarinë e nxënësve dhe mundëson të nxënët e qëndrueshëm kurse përdorimi i drejtë metodave mësimore ndikon edhe në formimin e personalitetit të nxënësve, duke i aftësuar dhe përgatitur ata për jetë dhe punë, sidomos për vet arsimim dhe vetë mësim. (Zylfiu, N., 2011)

Metodat mësimore ndihmojnë vënien e takimit të nxënësve me përmbajtjet mësimore dhe përmes përdorimit të teknikës mësimore, nxisin nxënësit që t'i transformojnë ato, njëherit që ta transformojnë edhe vetën, duke fituar njohuri, zhvilluar shkathhtësi dhe formuar shprehi jetësore edhe punuese në përgjithësi dhe rreth kulturës gjuhësore në veçanti. (Garo, 2011)

Mësimdhënia bashkëkohore lejon që nxënësit të marrin pjesë në një shumëllojshmëri aktivitetsesh, ku ata mund të mësojnë nga njëri-tjetri, mund të diskutojnë e ndajë idetë e tyre, dhe të punojnë në çifte apo grupe të vogla.

Nëse nxënësit përfshihen më shumë në veprimtari të ndryshme gjatë të nxënës, edhe rezultatet do të jenë më të mira. Mësimdhënia bashkëkohore mbështetet në disa parime:

1. Aftëson nxënësit për të nxënës e pavarur
2. Nxiti nxënësit që të jenë nismëtar
3. Krijohet dallueshmëri në të nxënë dhe nxitet të menduarit kritik, krijues.
4. Nxiti dhe krijon kushte për komunikim shumëkahor dhe të frytshëm.
5. Aftëson nxënësit për vlerësim dhe vetëvlerësim

Shkolla sot është një institucion që synon të përgatit gjeneratat e reja për të kërkuar informacionin, për të operuar dhe analizuar në mënyrë kritike si dhe për të aftësuar nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin probleme në mënyrë kritik. (Musai, B, 2003)

Mësimdhënësi duhet ta bëjë mësimin sa më interesant për nxënësit dhe në klasë të ketë dinamikë, sepse nëse mësimdhënësi përdorë gjithmonë teknika të njëjta mësimi bëhet monoton dhe nxënësve u largohet interesi për njohurit e reja që merren.

Andaj në mësimdhënie është shumë e rëndësishme përzgjedhja dhe përdorimi i teknikave që do të përdorë mësimdhënësi në klasë.

Përdorimi i teknikave të përshtatshme pedagogjike dhe metodologjike ndikojnë në mësimdhënien dhe të nxënës efektivë. (QTKA, 2005)

Efektet e teknikave ndërvepruese mësimore të cilat sjellin disa ndryshime në punën mësimore të mësimdhënësit dhe të nxënës, ndryshon mënyrën e mësimdhënies, planifikimit të orës mësimore, menaxhimit të klasës, zbatimit të metodave interaktive etj., ndërsa te nxënësi vërejmë këto ndryshime: aftësinë për të menduar në mënyrë kritike, demonstrimi i njohurive të kuptuara, përpjekja për të dhënë përfundime logjike, dëshira për të parashtruar pyetje, bashkëveprimi në klasë, rritja e interesimit për të dhënë ide të reja. (KEC, 1998)

2.3

Zhvillimi i shkathtësisë së komunikimit - komunikues efektiv

Komunikimi është mjete themelor për të shprehur idetë dhe mendimet, por edhe për të krijuar raporte me të tjerët. Kompetenca e komunikimit (komunikues efektiv) është rezultat i procesit të vazhdueshëm të punës nga fëmijëria deri në formimin e plotë të tij/saj.

Korniza Evropiane e Kompetencave aftësinë komunikuese e ndan në gjuhën amtare dhe aftësinë e komunikimit në gjuhën e huaj.

Sipas kësaj kornize, komunikimi është aftësia për t'i shprehur dhe interpretuar mendimet, ndjenjat dhe faktet në formë verbale dhe të shkruar (dëgjimi, të folurit, leximi dhe shkrimi), si dhe ndërveprimi gjuhësor në mënyrë të përshtatshme në nivel të plotë të kontekstit social dhe kulturor edukim dhe formim, punë, familje dhe kohë të lirë. (QTKA, 2005)

Nga përvoja e tij, psikologu Naiditch jep një shembull domethënës se si mësime dhënësit në përpjekje për të zhvilluar komunikimin dhe mendimin kritik nxënësve u parashtrajnë pyetje të cilat bllokojnë komunikimin dhe mendimin, në vend se ta kultivojnë atë (Naiditch, 2017).

Në analizën e tij, Miller trajton çështjen e kompetencave të mësime dhënësit për mësime dhënë të suksesshme. Sipas tij, kompetenca pedagogjike për mësime dhënë, ku përfshihen njohuri dhe shkathtësi të mjaftueshme për punë efektive me nxënës duke përfshirë edhe metodikën e mësime dhënies për zhvillimin e aftësive komunikuese dhe të mendimin kritik si proces vijanoz (Miller, 2003)

Proceset e komunikimit janë procese jetike për një diskutim të suksesshëm. Nxënësit duhet të mësohen dhe të nxiten të dëgjojnë cka thot secili person, dhe të përgjigjen saktë. Pjesëmarrja e të gjithëve është pjesë e procesit. Komunikimi në klasë fillon në çastin kur nxënësit drejtojnë pyetje dhe kur një nxënës përgjigjet për atë që ka thënë një nxënës tjetër. (Maki, 2002)

Nxënësit mund të përdorin grupe të përbashkëta për të lexuar materiale, për të shkruajtur përmbledhje, për të gjetur informacion të veçantë dhe për tu përgjigjur pyetjeve.

Tek të nxënit në bashkëpunim, nxënësit komunikojnë, ndihmojnë njëri tjetrin me detyra për të mësuar dhe nxitin suksesin e njëri-tjetrit.

Njësitë në grupe me të vogla i lejojnë nxënësit të punojnë drejtëpërdrejtë me njëri-tjetrin, të shkëmbejnë ide dhe mendime, dhe të arrijnë mirëkuptim të përbashkët.

Parësore mbetet komunikimi efektiv, të kupturit, vendimmarrja, dhe zgjidhja e problemeve (Musai B. , Të menduarit kritik: Çfarë është dhe çfarë mund të jetë?, 2003)

2.4 Pse aftësitë e komunikimit janë të rëndësishme për nxënësit?

Zhvillimi i hershëm i shkathtësive të gjuhës dhe komunikimit vlerësohet të jetë thelbësor për suksesin e fëmijëve në edukimin e tyre të mëtijshëm në shkollë dhe më gjerë. Për më shumë, zhvillimi i gjuhës dhe i komunikimit në fazat e hershme, po ashtu konsiderohet të parandalojë fëmijët nga vështirësitë në të nxënë, dhe të rritë gjasat për arritje më të larta të tyre në shkollë (Wragg, 1997) Suksesi në shkollë, në ditët e sotme kërkon një proces mësimor aktiv, rinovuar në përmbajtje e në formë, gjë që gjen shprehjen konkrete në përdorimin e metodave, strategjive e teknikave mësimore bashkëkohore ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse (Zhitija-Gjelaj, 2011)

Në anën tjetër, Qendra e trajnimit dhe kualifikimit në arsim (QTKA, 2005) vlerëson se vëmendja e shkollës së sotme sa vjen e drejtohet me përparësi tek përgjegjësitë që duhet të marrin nxënësit gjatë procesit të të mësuarit dhe të të nxënit.

Aftësitë e komunikimit janë të rëndësishme për nxënësit e shkollës fillore, sepse ato janë themeli për të suksesi akademik, zhvillimi social-emocional dhe suksesi i përjetshëm. Aftësitë e mira të komunikimit janë thelbësore për sukses në të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë shkollën, punën dhe marrëdhëniet. Shkolla fillore është koha kryesore për të zhvilluar këto aftësi, pasi fëmijët po mësojnë dhe po rriten me shpejtësi (Anderson, P.A., & Lynch, J. A., 2016)

Përdorimi i metodave në thelb e ka ndërveprimin sigurojnë kushte që nxënësit të paraqesin idetë, pikëpamjet dhe informacionet që ata zotërojnë. Ndër më kryesoret dhe më të thjeshta është diskutimet që bëhen në klasë dhe zakonisht fillojnë me parashtrimin e ndonjë pyetjeje qoftë nga nxënësit apo nga mësuesi. (Garo, 2011)

Sipas Garos, diskutimi mund të përkufizohet si një bisedë e qëllimshme, e cila ka një objektiv të caktuar dhe i mëson nxënësit më mirë si të mendojnë. Procesi i diskutimit iu jep mundësi nxënësve t'i përpunojnë konceptet, duke i kuptuar kështu më thellë. Diskutimet në një mënyrë janë një mendim që shërben për t'i trajnuar nxënësit me shkathtësi komunikuese dhe për krijimin dhe zhvillimin e shprehjeve të reja sociale. Kontributi madhor i diskutimit është mundësia që jepet për të praktikuar të menduarit kritik dhe krijues (Garo, 2011)

Me anë të diskutimit mundësohet që e tërë klasa të ketë qasje në mësim. Mbi të gjitha, ato janë mundësi që nxënësit të mësojnë duke marrë informacion, duke menduar për argumentet dhe duke zhvilluar e krijuar shkathtësitë për të testuar idetë që jep. (Musai, B, 2003)

2.5. Realizimi i aktiviteteve, roli dhe funksioni i tyre në zhvillimin e aftësive të komunikimit

Në mësimdhënie është shumë e rëndësishme përzgjedhja dhe përdorimi i metodave që do të përdorë mësuesi. Mësuesi duhet ta bëjë mësimin sa më interesant dhe në klasë të ketë dinamikë, sepse nëse mësuesi përdor gjithmonë të njëjta metoda mësimi bëhet monoton dhe nxënësve u largohet interesi për njohuritë e reja që do të mirren (Pattnaik .Ch, Ashok .Ch, Banerjee.Sh., 1986)

Edhe roli i mësuesit në të kaluarën u përqendrua vetëm si prezantues. Në krahasim me sistemin e tanishëm të arsimit, mësuesi vepron më shumë si lehtësues i njohurive që nxënësit të përgatiten dhe sensibilizohen më mirë për të prodhuar dhe përdorur situata mësimore në mënyrë efektive (Bryman, 2012)

Sipas Asllan Vrapit (Vrapi, A., 2015) mësimdhënia me anë të zgjidhjes së problemeve zhvillon aftësitë për organizim dhe udhëheqje, zgjidhjen e problemeve, punë në grupe, komunikim, zbatim të njohurive, punë të pavarur dhe vetëorientim, përdorim të teknologjive informative dhe në fund por jo më pak e rëndësishme zhvillon të menduarit kritik dhe krijues.

Një faktor i rëndësishëm radhitet edhe puna në grupe të vogla, e cila mundëson një mjedis aktiv në klasë dhe me anë të kësaj arrihet të sigurohet të nxënësit ndërveprues dhe krijimi i atmosferës që karakterizohet me shkëmbimin e informacionit. (Simon, 1999)

Aktivitetet e orës mësimore në fazën hyrëse të saj kanë filluar kryesisht me përsëritje dhe reflektim për njësitë mësimore paraprake Në pjesën kryesore të zhvillimit të aktiviteteve përqendrimi në vëzhgim është fokusuar në: Integrimin e strukturave gjuhësore me shkathtësitë e komunikimit; integrimin e teksteve letrare dhe joletrare me strukturat gjuhësore; përcaktimin e aktiviteteve në funksion të zhvillimit të shkathtësive të komunikimit dhe të njohurive gjuhësore; përcaktimin e aktiviteteve në funksion të arritjes së rezultateve për orën mësimore; shkallën e përkrahjes së nxënësve në aktivitete; shkallën e ndërlidhjes së shpjegimeve me shembuj dhe situata konkrete; praktikat e ndërveprimit në klasë; përdorimin e burimeve të ndryshme të informacionit përveç tekstit bazë; përdorimin e materialeve dhe mjeteve mësimore për ta ndihmuar zhvillimin e aktiviteteve. (Zylfiu N. , 2004)

Kapitulli II

3.1 Cka është mendimi kritik?

Të menduarit është një proces aktiv, ndërveprues dhe i ndërlikuar që realizohet nëpërmjet të folurit dhe të shkruarit, dhe kërkon kushte siç janë mjediset që e nxisin dhe e përkrahin atë.

Është një proces i vazhdueshëm që duhet të zhvillohet në mënyrë sistematike. Të menduarit krijues dhe kritik nuk është pjesë e një kurrikuli të veçantë, është proces që përshkon të gjitha lëndet pavarësisht se në cilën klasë apo cikël zhvillohet (QTKA, 2005)

Në literaturën didaktike gjejmë një numër përkufizimesh për mendimin kritik. Në “Fjalorin pedagogjik” të menduarit kritik përcaktohet si veti e të menduarit, i cili ka të bëjë me analizën e gjithëanshme dhe me kontrollimin kritik të fakteve, hipotezave dhe të dhënave tjera të cilat përvetësohen. Vlerësimi kritik i hipotezave bënë të mundshëm seleksionimin e përgjigjeve, hedhjen poshtë të atyre që nuk mundësojnë të arrihet qëllimi dhe fiksimi i atyre që qojnë kah zgjidhja e problemit (Enciklopedia., 1989)

Në literaturën amerikane (Musai, 2003) për nocionin “të menduarit kritik” autorët japin përkufizime në mënyra të ndryshme. Më poshtë kemi veçuar disa përcaktime për të menduarit kritik sipas ekspertëve:

- Mendimi kritik është formimi i përfundimeve logjike,
- Mendimi kritik është vendimmarrja e arsyeshme dhe e reflektuar për atë çka duhet të besojmë dhe të bëjmë,
- Mendimi kritik është arti i të menduarit për ta bërë të menduarin tuaj më të mirë, më të qartë, më të saktë, më të justifikueshëm,
- Mendimi kritik është arti i të pasurit të drejtë.

Shikuar nga një perspektivë tjetër, mendimi kritik është një proces kompleks i integritetit të ideve dhe burimeve në mënyrë kritike, i rikonceptimit të koncepteve dhe informacionit (Balhysa, 2001)

Një përkufizim tjetër nga literatura shqipe është si vijon: Mendimi kritik nuk ndodh rastësisht, ai kërkon vëmendje, kohë dhe kujdes nga nxënësit për tu përmbushur. Kjo do të thotë se mendimtarët kritikë janë aktivë, e pranojnë me lehtësi informacionin e ri, e përshtatin me informacionin e

mëparshëm, analizojnë, arsyetojnë, reflektojnë dhe në këtë mënyrë ata zgjidhin probleme të ndryshme, si dhe prodhojnë ide të reja (Musai, B., 2004)

Mendimi kritik është procesi i disiplinuar intelektual i konceptualizmit në mënyrë aktive dhe të shkathet të zbatimit, analizimit, sintetizimit ose vlerësimit të informacionit të mbledhur nga vëzhgimi, përvoja, reflektimi, arsyetimi ose komunikimi, si një udhëzues për besimin dhe veprimin. (Trëndafili, 2008)

Aftësitë e të menduarit kritik nënkuptojnë :

Kerkimin në mënyrë aktive të gjitha anët e një argumenti

Testimi i qëndrueshmërisë së hipotezave të hedhura.

Testimi i qëndrueshmërisë së provave të përdorura për të mbështetur hipotezat.

Zhvillimi i aftësive të të menduarit kritik në kurrikulë ndihmon për të forcuar qytetarët e arsimuar, për të përgatitur studentët për studimet e mëtejshme, promovon karrierën e ardhshme dhe jetën shoqërore (Starkey, 2004)

Gjatë shqyrtimit të literaturës hasen konceptet “mendim kritik dhe mendimi kreativ” që do të thotë se shumë autorë i përdorin të dy terminologjitë në një. Lidhur me këtë, mendimi më i duhur është si vijon: Mendimi kritik dhe kreativ, mund të konsiderohen dy anët e monedhës së njëjtë.

Nickerson (1999) thotë se mund të argumentohet se të mendosh mirë kërkon aftësi kritike dhe kreative që nuk kanë efekt pa njëra tjetrën. Këto nuk janë vetëm aftësi personale të nxënësve por është edhe roli i mësimit në nxitjen e nxënësve dhe sigurimin e mjedisit të duhur që do të lejojë nxitjen e të menduarit kritik (Padget, 2008)

Mendimtarët kritikë kanë disa karakteristika ku mund të përmendim:

- Ata janë kuriozë për atë që vëzhgojnë apo dëgjojnë.
- Kanë dëshirë për të kërkuar të vërtetën.
- Komunikojnë në mënyrë të qartë dhe me logjikë.
- Mendimtarët kritikë janë kërkues si dhe konsiderojnë pika të shumta para se të arrijnë një përfundim
- Ata kanë një ndjeshmëri intelektuale.
- Mendimtarët kritikë janë në gjendje të zhvillojnë konkluzionet e arsyeshme duke përdorur analizën, vlerësimin dhe përfundimin. (Balhysa, 2001)

3.2 Rëndësia e mendimit kritik në klasë

Të menduarit kritik e krijues ndodh atëherë kur nxënësit fillojnë të reflektojnë ndaj asaj që lexojnë, fillojnë të bëjnë pyetje, fillojnë të krijojnë lidhje ndërmjet njohurive që dinë dhe njohurive të reja që mësojnë, seleksionojnë informacionin, analizojnë sjellje, veprime e situata, argumentojnë dhe mbajnë qëndrime të caktuara ndaj tyre. (Musai B. , Të menduarit kritik: Çfarë është dhe çfarë mund të jetë?, 2003)

Detyrë e shkollës sot është që t'i aftësojë nxënësit në kërkimin e informacionit si dhe përdorimin e duhur të tij. Nxënësit duhet të mendojnë në mënyrë të tillë që të bëjnë zbulime për veten e tyre, të jenë kreative dhe sa më origjinale, të shprehin qartë dhe pa ngurim atë që ata e mendojnë. Kjo arrihet vetëm duke zhvilluar mësimdhënien dhe të nxënës ndëreveprues në kuadër të mendimit kritik. Mendimi kritik është diçka që kultivohet. Të menduarit kritik, konsiderohet shtylla bazë e mësimdhënies bashkëkohore, mbi të cilin parashihet realizimi i veprimtarisë edukativo mësimore. Të menduarit kritik është një formë e re e mësimdhënës dhe të nxënës bashkëkohor që zbatohet në të gjitha nivelet e mësimin. (KEC, 1998)

Në shkollë, të nxënës për të menduar në mënyrë kritike, më mire duke e provuar si një rrugë të përvetësimit të përmbajtjes, si diçka që është pjesë e rezultateve të pritshme. (Musai, B., 2003)

Nxënësi fillon të mendojë në mënyrë kritike atëherë kur nis të vlerësojë, të hulumtojë dhe të krijojë ide të reja. Të menduarit kritik arrihet duke njohur dhe duke zbatuar praktikisht të gjitha metodat, teknikat ndërevepruese që e ndihmojnë këtë proces të ndërlikuar. (Ismajli, 2012)

Mendimi kritik nuk rrjedh vetëm prej mësimdhënies, por zhvillohet më mirë kur rrjedh nga vet kureshtja e nxënësve, me sfida të vërteta për të cilat nxënësit janë vetë të interesuar. Mendimi kritik është proces njohës veprues dhe ndëreveprues në disa nivele të të menduarit. (Musai, B. , 2003)

Nxënësit që mendojnë në mënyrë kritike, zakonisht janë entuziastë për të mësuar. Ata aftësohen të përballojnë sfidat dhe shohin mundësi për të nxënë edhe në detyrat më të vështira. (Temple, 2006)

Nëse arrijmë ta realizojmë këtë qëllim në rrethin stimulus në të cilin fëmijët dëshirojnë të mësojnë, sepse ajo që u ofrohet në klasë është interesante dhe thelbësore, atëherë njohuritë dhe shkathhtësitë e arritura do t'i ruajnë gjatë tërë jetës. (Miller, B. , 2005)

3.3 Mjedisi mësimor nxitës për zhvillimin e komunikimit dhe mendimit kritik

Në mësimdhënie është shumë e rëndësishme përzgjedhja dhe përdorimi i metodave që do të përdorë mësuesi. Mësuesi duhet ta bëjë mësimin sa më interesant dhe në klasë të ketë dinamikë, sepse nëse mësuesi përdor gjithmonë të njëjta metoda mësimi bëhet monoton dhe nxënësve u largohet interesi për njohuritë e reja që do të merrën. Përdorimi i metodave të përshtatshme pedagogjike dhe metodologjike ndikojnë në mësimdhënien dhe të nxënësve efektiv. (Pattnaik .Ch, Ashok .Ch, Banerjee.Sh., 1986) Mësimdhënia e ndërtuar mbi parime dhe metodologjitë e të menduarit kritik krijojnë klasa më në qendër fëmijen, krijojnë vërtetë bashkësi të fuqishme të të nxënësve.

Mësuesi zhvillon me nxënësit veprimtari të ndërthurura shkrimi, leximi dhe të foluri, krijon kushte që nxënësit të kërkojnë, të mësojnë, të analizojnë, të reflektojnë dhe të shfaqin gjithë potencialin e tyre, të demonstrojnë jo vetëm atë që e dinë po edhe atë që janë në gjendje të bëjnë.

Për tu arritur këto shkathësi Lauren Starkey në veprën “Critical Thinking Skills Success” nënvizon veprimet: Të vërejturit, nxitja e kureshtjes, kërkimi i pyetjeve dhe gjetja e burimeve të reja, sfida dhe kontrollimi i asaj që besojnë, supozimi dhe mendimi për faktet kundërtshënës, vlerësimi dhe paraqitja e argumenteve, marrja e vendimeve dhe gjetja e zgjidhjeve të vlefshme, argumentimi logjik i fakteve dhe situatave (Starkey, 2004)

Mjedisi mësimor konsiderohet një aspekt shumë i rëndësishëm mbi nxitjen e mendimit kritik janë edhe pyetjet që bëhen në klasë. Pyetjet e nxënësve gjatë zhvillimit të mësimin dhe veprimtarive në klasë janë forma të veçanta që flasin për mendimin e nxënësve. Pyetjet e nxënësve gjatë zhvillimit të mësimin dhe veprimtarive në klasë janë forma të veçanta që flasin për mendimin e nxënësve. Pyetjet luajnë role të shumta në njohje. Ato mund të ndihmojnë nxënësit të përsërisin informacionin për ta mbajtur mend më mirë. Ato mund të funksionojnë për të identifikuar mangësitë në fondin e njohurive si dhe për të nxitur kureshtjen dhe interesin afatgjatë. (Woolfolk, 2010).

Përmes pyetjeve nxënësit kanë qasje reflektuese, kritike, imagjinojnë, analizojnë të dhëna, sintetizojnë ide, krijojnë apo vlerësojnë njohuritë, tregojnë se të menduarit e nxënësve është i një niveli të lartë (Ismajli, 2012)

Mendimtarët kritikë janë aktivë, punojnë në mënyrë sistematike, reflektojnë ndaj njohurive bazë për të ripërceptuar vetën dhe kanë si tipar mënyrën si e përceptojnë botën e tyre gjatë rritjes dhe të nxënësve. Nuk mund të merret si e vërtetë se nxënësit do të vijnë tek mendimi kritik në mënyrë të natyrshme

apo vetëm sepse deklarohet se ai është i rëndësishëm (Musai. B, Të menduarit kritik: Çfarë është dhe çfarë mund të jetë?, 2003)

Mësimdhënësit duke e ditur rëndësinë e zhvillimit të mendimit kritik te nxënësit duhet të bëjnë të mundur për ta lehtësuar zhvillimin e mendimit kritik tek nxënësit, duke i mësuar ata të:

- Identifikojnë dhe formulojnë çështje dhe probleme të rëndësishme në mënyrë të qartë dhe të saktë.
- Mbledhin, vlerësojnë dhe analizojnë informacionin e nevojshëm për të adresuar pyetje dhe për të zgjidhur probleme.
- Të arrijnë në përfundime dhe zgjidhje të argumentuara mirë që janë në përputhje me informacionin e disponueshëm.
- Konsiderojnë interpretimet alternative, pëfundimet dhe zgjidhjet, dhe t'i diskutojnë dhe sfidojnë ato në mënyrë logjike dhe me të dhënat tjera, ose të rishikojnë interpretimin, përfundimin ose zgjidhjen për të përfshirë këto alternativa që ata i kanë.
- Identifikojnë supozimet që mbështesin mendimin e tyre dhe të tjerëve.
- Përdor koncepte abstrakte, modele dhe teori për të thelluar kuptimin e mendimit të tyre.
- Komunikojnë efektivisht me të tjerët për të arritur një zgjidhje të përbashkët ose për të ndarë zgjidhjet me një audiencë më të gjerë. (Qendra për Demokraci dhe Pajtim në Europën Juglindore, 2013)

Duke e ditur që të menduarit kritik gjatë zhvillimit të tij është një proces kompleks, që kërkon nga nxënësit që të :

- Përqëndrohen në informacionin e rëndësishëm dhe të injorojnë atë që nuk është i rëndësishëm.
- Skanojnë, krahasojnë dhe përzgjedhin informacionin në përputhje me qëllimin e caktuar.
- Paraqesin informacionin e zgjedhur në një menyrë konkrete, duke përdorur modele dhe duke lidhur atë me idenë egzistuese.
- Vlerësojnë modelet në bazë të provave të disponueshme dhe të nevojshme.
- Analizojnë lidhshmërinë e fortë të informacionit me besimet, teorinë dhe pikëpamjet mbizotëruese aktuale.
- Kodojnë, simbolizojnë dhe aplikojnë njohuritë e reja në kontekstin e dijes dhe kuadrit aktual, duke e përshtatur me nevojat e tyre. (Qendra për Demokraci dhe Pajtim në Europën Juglindore, 2013)

3.4

Aplikimi i metodave për nxitjen e të menduarit kritik

Përdorimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhës nxit veprimtarinë e nxënësve dhe mundëson të nxëniet e qëndrueshëm. Përdorimi i drejtë metodave mësimore ndikon edhe në formimin e personalitetit të nxënësve, duke i aftësuar dhe përgatitur ata për jetë dhe punë, sidomos për vet arsimim dhe vetë mësim. (Zylfiu, N., 2011).

Mësuesit janë burim i pashtershëm, githmonë në pasurim të ideve dhe materialeve më të vlerëshme që përgatitin dhe përdorin me nxënësit e tyre.

Megjithëse kur tregohen nga ekspertët e fushës, metodat duket se funksionon si duhet, mësuesit jo rrallë ndeshen në vështirësi kur ato vihen në zbatim me nxënësit e tyre, në situata konkrete në klasë. Për këtë qëllim, rregullat e mëposhtme ndihmojnë mësuesit që të shmangin mosbesimin kur përdorin metodat e reja me nxënësit e tyre.

Pasi të keni vendosur se qfarë doni që të mësojnë nxënësit tuaj, cilat janë qëllimet apo objektivat tuaja në atë temë, atëherë mund të analizoni si duhet rrugën që do të ndiqni.

Një metodë e përdorur në klasë mund të funksionoj mirë lidhur me disa objektiva dhe materiale, ndërsa me të tjera shumë pak.

Sigurohuni që strategjia juaj e mësimdhënies harmonizohet me qëllimet tuaja të të nxëniet.

Së dyti, ka rëndësi procesi i të menduarit të nxënësi dhe jo vetëm metoda e veçantë e përdorur në klasë. Ndjekja fanatike e hapave të një metode nuk siguron githsesi që nxënësit do të përfshihen në atë lloj të menduari që qon në të nxëniet të thellë dhe logjik.

Nxënësit mund të bien në rutinë e të " bëjnë sikur po mësojnë"

Së treti, rregulloni atë qfarë po bëni, për të harmonizuar interesat nxënësve me qëllimet tuaja. Megjithëse strategjitë në klasë shpesh përshkruhen si hapa të rëndësishëm, jeni të vetëdijshëm për atë mënyrë të menduarit që doni të nxitni tek nxënësit dhe pëgjigjuni si duhet.

Së pari, ajo qfarë po mësojnë nxënësit ishte më e rëndësishme se metoda që përdoret për të zhvilluar procesin e mësimdhënies dhe nxënies, për të zhvilluar njohuritë, shkathtësitë dhe dituritë dhe për të rritur nivelin e dijes së nxënësve, duhet të përdoren të gjitha metodat, mënyrat, strategjitë, procedimi i objektivave dhe rezultatit si proces i nxënies së mësimi (Musai, B, 2003)

Metodat e mësimdhënies të përdorura në klasë, kategorizohen edhe nga llojet e të menduarit në të cilat përfshihen nxënësit gjatë zhvillimit të mësimi.

Veprimet njohëse, të nxjerra si përfundim nga një metodë, ndërlidhen me tri faza të mësimi:

- Përgaditja e nxënësve për të ndeshur një përmbajtje të re
- Udhëheqja e nxënësve gjatë të nxënit gjatë të nxënit të tyre,
- Rivlerësimi ose ndërtimi në hapat e mëtutjeshëm të procesit të të nxënit.

Përzgjedhja e metodave dhe kombinimi i tyre është punë e mësimdhënësit. Nganjëherë thuhet se metodë e mire është ajo të cilën e zotëron mësimdhënësi.

Secili mësimdhënësi duhet të zotërojë të gjitha metodat, tërësia e cilave përfshin shumëllojshmërinë e lëndës mësimore. (Sylejmani, 2012)

Mësimdhënësi ka të drejtë të zgjedhë metodat dhe strategjitë bashkëkohore të planifikimit të mësimdhënies në përputhje me objektivat mësimore dhe kapacitetet që kanë nxënësit.

Metodat të cilat zakonisht përdoren për të ngritur nivelin e mendimit kritik janë:

- Metoda e diskutimit(bashkëbiseduese)
- Metoda e demonstrimit
- Metoda e aktivitetit praktik (Wragg, T., 1997)

3.4.1 Metoda e diskutimit (bashkëbiseduese)

Bashkëbisedimi si metodë mësimdhënësi duhet ta shfrytëzojë që t'u zhvillojë edhe kulturë në të foluritë, pasi i nxit ata për të shprehur mendimet me fjali të ndërtuara saktë nga ana gjuhësore. Kjo metodë mundëson pjesëmarrjen aktive të të gjithë nxënësve në mësim dhe nxit veprimtarinë e tyre mendore. (Syla, 2017)

Diskutimi nxit të menduarit, kur nxënësit dëgjojnë më vëmendje dhe më kujdes për ato që thonë të tjerët dhe më pas i modifikojnë apo zgjerojnë të menduarit e tyre.

Në këtë mënyrë ata rivlerësojnë opinionet e tyre, formulojnë ide të reja, nxjerrin përfundime, mendojnë në mënyrë logjike dhe kritike dhe marrin në konsideratë pikëpamje të ndryshme.

Në klasë ndodhin disa lloje diskutimesh, ndër më të përhapurit janë diskutimi me njëri-tjetrin dhe ai kryhet nën drejtimin e mësuesit.

Të dy këto lloj diskutimesh kanë përparësi mësuesin, si cili si pjesëmarrës në diskutim mund të ndihmojë të menduarit dhe të përvijojë procedurat për bashkëveprim në grup.

Pa ndihmën ose pa ndërhyrjen e mësuesit, nxënësit mund ti marrin vete role udhëheqëse dhe mund të trajtojnë çështjet në mënyrë të hapur dhe të ndershme. Nxënësit që marrin pjesë në diskutimet e udhëhequra nga nxënësit, ndryshe nga ato të udhëhequra nga mësuesi, përfshihen në proceset e të menduarit të nivelit të lartë. (Musai,B, 2005)

Pjesëmarrja aktive zhvillon të menduarit logjik e kritik, rrit te nxënësit aftësinë e përgjegjësinë e për t'u përgjigjur sa më saktë. Bashkëbisedimi dhe gjithë struktura e orës së mësimi duhet të bëjnë të mundur që mësimi të ketë ritëm, me çaste të vëmendjes intensive dhe të reflektimit.

Bashkëbisedimi është lidhur ngushtë me të pyeturit. Të përdorësh bashkëbisedim, nuk do të thotë të lësh mënjatë metoda e forma të tjera të punës. Çelësi i suksesit të bashkëbisedimit qëndron në faktin se sa i zoti është mësimdhënësi që të kombinojë metoda të tjera që mbështetin bashkëbisedim (Rama, 2011)

3.4.2 Metoda e demonstrimit

Metoda e demonstrimit motivon nxënësit të vërejnë, analizojnë, krahasojnë, diferencojnë, të gjejnë ngjashmëritë dhe dallimet, të bëjnë analizën dhe sintezën e karakteristikave themelore të dukurive dhe të proceseve gjuhësore, të formojnë përfytyrime audio-vizuale, koncepteve, të nxjerrin konkluzione dhe të ushtrojnë t'i zbatojnë në praktikën gjuhësore në formë të ushtrimeve të leximit letrar dhe të shprehurit me gojë dhe me shkrim . (Brada, 2005)

Demonstrimi nxit nxënësit të shprehin idetë e tyre në mënyrë të qartë dhe të strukturuar, e që mbështetet kryesisht në parimin e konkretizimit, të aktivitetit të vetëdijshëm dhe në parimin e lidhjes së teorisë me praktikën mësimore dhe jetësore.

Kjo i ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësinë për të komunikuar me argumente të forta, duke bërë që te u rritet vetbesimi dhe të kenë sukses më të madh në jetë. (Rama, 2011)

3.4.3 Metoda e aktivitetit praktik

Metoda e aktivitetit praktik nënkupton rolin primar të mësimit nxënësit, por edhe më shumë të nxënësit në procesin e përvetësimit, zotërimit dhe zbatimit praktik të njohurive, të shkathtësive dhe të shprehive nga gjuha, nga kultura e të shprehurit me gojë dhe me shkrim, etj

Nga mësimit nxënësi kërkohet që të peshojë drejt përmbajtjet gjuhësore, të cilat duhet dhe mund t'i përvetësojë dhe zotërojnë nxënësit me ndihmën e aktivitetit praktik mësimor.

Duke ushtruar nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur, të zotërojnë pengesat dhe vështirësitë, të nxiten të gjejnë mënyra dhe mjete më adekuate pune dhe veprimi, të nxjerrin konkluzione dhe t'i zbatojnë edhe në mënyrë të pavarur edhe në shtëpi (Rama, 2011)

3.5 Struktura ERR dhe mendimi kritik

Struktura për të menduarit dhe të nxënit është një procedurë përmes së cilës mësuesit udhëheqin nxënësit drejtë arsytimit. Ajo jo vetëm mund të përshkruhet për çdo pjesë të saj, por mund të perceptohet edhe si strategji e ndërfutur edhe mjaft e lidhur. Struktura është e zhvilluar rreth përmbajtjes së një mësimi. Nuk është e kufizuar vetëm në përmbajtjen e mësimi, por është e zbatueshme në të gjitha situatat e të nxënit.

Fazat e strukturës:

E: * I. **Evokimi** (diskutim para përmbajtjes)

1. Cila është tema? (dalloje atë)
2. Cfarë dini rreth saj? (radhiti në tabelë)
3. Çfarë prisni, dëshironi ose keni nevojë të mësoni rreth saj? (radhiti në tabelë)

R: *II. **Realizimi i kuptimit**- i bërë prej nxënësit, në kohën kur kërkon informacione

R: *III. **Reflektimi** (diskutimi pas përmbajtjes)

1. Cfarë mësuat? (zgjeroni pyetjet, sa më shumë të mundeni)
2. Bëni pyete me kundërpergjigje, për të nxjerrë informacionin papërmendur në fazën e evokimit.
3. Pas përgjigjive të pyetjeve mund të pyesni: "Pse mendoni kështu?"

Struktura trifazëshe e mësimi **ERR** ndihmonë në afirmimin e nxënësit në qendër dhe nxitjen e mendimit kritik, sepse pothuajse në secilën fazë të saj nxënësit i kërkohet të mendojë dhe të shpreh atë që di.

Evokimi është faza e parë e fillimit të strukturës për zhvillimin e të menduarit dhe të nxënit.

Mësuesi në këtë fazë mund të nxjerrë disa mendime nga nxënësit, duke i pyetur rreth ideve të cilat nuk janë diskutuar më parë.

Gjatë kësaj faze është e rëndësishme që mësuesi t'i përmbahet procedurës nga biseda deri në zgjerimin e mundshëm të bisedës, e cila zgjat aq sa ai e sheh të arsyeshme dhe më pas i lë nxënësit të flasin. Roli i mësuesit është të drejtojë dhe të kuptojë mendimin e të dëgjojë me kujdes idetë e

nxënësve. Në këtë hap të parë kryhen veprimtaritë e ndryshme njohëse. Së pari nxënësi është i përfshirë aktivisht në rikujtimin e tyre çfarë di rreth temës së mësimit.

Kjo e përqendron atë të shqyrtojë njohuritë e tij dhe të fillojë të mendojë më thellë rreth temës. Qëllimi tjetër i fazës së evokimit është të aktivizojë nxënësin të krijojë arsyetim të kuptimshëm, të qëndrueshëm dhe kritik përmes përfshirjes aktive në procesin e të nxënësit. Përmes përfshirjes aktive nxënësit bëhen të ndërgjegjshëm për të menduarit e tyre. (Musai, B., 2003)

Duke diskutuar në grupe rritet interesi i nxënësve dhe zbulohet karakteri i vërtetë i njohurive të tyre. Qëllimi i tretë, por jo më pak i rëndësishmi i evokimit është arsyetimi i vijueshëm, procesi për të lidhur informacionin e ri me skemat e mëparshme.

Faza e dytë e strukturës së të menduarit dhe të nxënësit quhet **Realizimi i kuptimit**.

Është kjo faza ku nxënësi bie në kontakt me informacionin ose idetë e reja. Në këtë fazë mund të përdoren strategji të mësimdhënies që i ndihmojnë nxënësit të marrin pjesë në mënyrë të qëndrueshme, gjithashtu është faza e të nxënësit, gjatë së cilës nxënësi duhet të ruajë pjesëmarrjen aktive të pavarur.

Detyra thelbësore e fazës së realizimit të kuptimit, është, së pari, ta mbajë nxënësin të përfshirë, të ruajë interesin për nxënie. Detyra tjetër është të mbështesë përpjekjet e nxënësve për të kontrolluar të kuptuarit. Nxënësit e suksesshëm, lexuesit frytdhënës i kontrollojnë të kuptuarit e tyre si një informacion të ri. Nxënësit pasivë vetëm kalojnë sipër gabimeve në arsyetim, të pavetëdijshëm, keqkuptimet apo mungesat e ndryshme të informacionit. (Trëndafil, 2008)

Nxënësit përmes të nxënësit aktiv kontrollojnë hap pas hapi përvetësimin e njohurive dhe përfitimin e kuptimit mbi tekstin si një informacion të ri. Detyra thelbësore e kësaj faze të dytë, realizimi i kuptimit, së pari, ta mbajë nxënësin të përfshirë, të ruajë interesin dhe ritmin e vendosur gjatë fazës së evokimit. (Raçi, A & Kuqi, S, 2017)

Faza e tretë është **Reflektimi**- kjo fazë shpesh harrohet në mësimdhënie.

Gjatë kësaj faze nxënësit konsolidojnë të nxënit e ri dhe në mënyrë aktive ristrukturojnë skemën e tyre për t'i përshtatur konceptet e reja. Është kjo faza në të cilën nxënësit marrin vetë njohuritë e reja të nevojshme.

Kështu ndodhë tek nxënësit e qëndrueshëm këtë rast ndodh një ndryshim i rëndësishëm.

Në qoftë se ky ndryshim është parë si arsyetim i ri, si rregull i ri i sjelljes, ose si bindje e re, të nxënit karakterizohet nga një ndryshim me të vërtetë i qëndrueshëm.

Ky ndryshim ndodh vetëm kur nxënësit përfshihen aktivisht në ristrukturimin e planit të tyre për të përshtatur të nxënit e ri. (Trëndafili, 2008)

Në këtë fazë përcaktohen objektiva, detyra të rëndësishme thelbësore.

Në radhë të parë nxënësit priren të fillojnë të shprehin me fjalët e tyre idetë dhe informacionin që ndeshin. Kjo është e rëndësishme për ndërtimin e planeve të reja, për të nxënit afatgjatë dhe arsyetimi në thellësi është vetjak. Nxënësit kuptojnë më së miri atë që kuptojnë në kontekstin e vet, me fjalët e veta. Arsyetimi është i qëndrueshëm, kur informacioni është i vendosur brenda një strukture me me përmbajtje të kuptimshme. (Raçi,A & Kuqi,S, 2017).

Qëllimi i kësaj faze është gjenerimi i shkëmbimit të fuqishëm të ideve midis nxënësve në lidhje me zgjerimin e fjalorit shprehës, ashtu sikurse ekspozimi i tyre në plane të ndryshme për nxënësit, për të marrë në konsiderate kur ndërtojnë vetë.

Përmes lejimit të diskutimit gjatë fazës së reflektimit nxënësit janë të ekspozuar ndaj një shumëllojshmërie ndërtimesh, që duhet marrë parasysh.

Kjo është një kohë ndryshimesh dhe rikonceptimi i procesit të të nxënit.

Ekspozimi në mënyra të ndryshme i integritit të informacionit në këtë kohë çon te ndërtimet shumë fleksibile të cilat mund të jenë të zbatueshme në praktikë (Rama, 2011)

3.5.1. Përparësitë e strukturës ERR

Struktura ERR është një kuptim i shkëlqyer i udhëheqjes së nxënësve në të gjitha kategoritë e niveleve përmes tekstit shkollor, i cili në shumicën e rasteve është përshkrues dhe ekspozues. Në fakt, sa më kompleks të jetë teksti, aq më i dobishëm është procesi. Pyetjet të cilat janë të hapura, por drejtojnë të lexuarit e nxënësit, mund t'i japin kuptim materialit të ndërlikuar, duke siguruar një strukturë brenda së cilës ata mund të ndërtojnë të kuptuarit. Duke qenë e hapur, struktura nuk pengon analizën kritike dhe fton parashikimin dhe mendimin e hapur. Duke drejtuar të lexuarit dhe të nxënësve, përmes përdorimit të strukturës ERR, përmbushën detyra të ndryshme, të rëndësishme të mësimdhënies. (Trëndafili, 2008)

Në këtë mënyrë struktura ERR:

- U lejon nxënësve të vendosin qartë qëllimet,
- Ruan angazhimin aktiv,
- Provokon diskutim të hapur,
- Nxit nxënësit të krijojnë dhe të bëjnë pyetjet e tyre,
- Ndhmon shprehjen e mendimeve të nxënësve,
- Ruan motivimin e nxënësve për të lexuar,
- Siguron një atmosferë ku respektohen mendimet,
- Krijon një shtresë për reflektim në atë që nxënësit vlerësojnë,
- Ngjallë shpresë për angazhimin kritik të nxënësve,
- Ndhmon mendimin kritik në nivele të ndërlikuara. (Trëndafili, 2008)

3.1 Taksonomia e Bloom-it për zhvillimin e mendimit kritik

Pyetjet e nxënësve gjatë zhvillimit të mësimi dhe veprimtarive në klasë janë forma të veçanta që flasin për mendimin e nxënësve. Studiues të ndryshëm veçojnë pyetjet që nuk janë riprodhuese dhe informuese janë treguesi më pozitiv i aktivizimit të menduarit të nxënësve.

Woolfolk thekson se teknikat e efektshme të bërjes së pyetjeve mund të jenë ndër mjetet më të fuqishme që mësuesit mund të përdorin gjatë orëve të mësimi. Pyetjet luajnë role të shumta në njohje. Ato mund të ndihmojnë nxënësit të përsërisin informacionin për ta mbajtur mend më mirë. Ato mund të funksionojnë për të identifikuar mangësitë në fondin e njohurive si dhe për të nxitur kureshtjen dhe interesin afatgjatë (Woolfolk, 2010)

Autorë të ndryshëm duke pasur parasysh modele të ndryshme pyetjesh duke përfshirë edhe ato kovergjente dhe divergjente janë të mendimit se modelet më të mira të pyetjeve për nxënësit më të vegjel dhe për nxënësit me aftësi të kufizuara të çdo moshe, janë pyetjet e thjeshta që mundësojnë një përqindje të lartë përgjigjesh të sakta, inkurajim më të madh, ndihmë kur nxënësit nuk gjejnë dot përgjigjen e saktë dhe lavdërim. Në klasë mund të bëhen ato lloj pyetje që nxitin të menduarit në çdo nivel të Taksonomisë së Blumit në fushën konjitive.

Woolfolk në Psikologjinë e Edukimit e ilustron më mirë me anë të tabelës:

Kategoria	Lloji i të mendurit që pritët	Shembuj
Njohja (të mbajturit mend)	Rikujtimi ose njohja e informacionit të mësuar	Përkufizoni ... Cili është kryeqyteti ... Ç'thuhet në tekst për ...
Përvetësimi tërësor (kuptimi)	Demonstrim i kuptimit të materialeve; shndërrim, riorganizim ose interpretim.	Shpjegoni me fjalët tuaja ... Krahasoni cila është ideja kryesore e ...? Përshkruani se çfarë patë ...
Zbatimi (duke zbatuar)	Përdorim i materialit për të zgjidhur një problem, e një përgjigje të vetme të saktë.	Cili parim demonstrohet në..? Llogarisni sipërfaqen e ... Zbatoni rregullën e ... për të zgjidhur ...
Analiza (duke analizuar)	Të menduarit kritik; identifikimi i arsyeve dhe i motiveve, bërje deduksionesh në bazë të dhënash specifike; analizë përfundimesh për të parë nëse mbështetën në fakte.	Çfarë ka ndikuar në shkrimet e ...? Pse u zgjodh Uashington DC ...? Cilat nga këto që vijnë janë fakte dhe cilat opinione ...?
Sintezë (duke krijuar)	Të menduar divergjent original; plan, propozim, projekt ose tregim origjinal.	Cili do të ishte një emër i mirë për ...? Si mund të mbledhim para (fonde) për ...? Si do të ishin Shtetet e Bashkuara po të kishte fituar Jugu...?
Vlerësim (duke vlerësuar)	Gjykim i meritave të ideve, ofrim opinionesh, zbatim standardesh.	Cili senator i SHBA-së është më i efektshëm? Cila pikturë mendoni se është më e mirë? Pse? Pse do ta favorizonit ju?

Tabla 1. Llojet e pyetjeve sipas Taksonomisë së Bloom.

Tabela 1 ilustron nivelet e ndryshme të të menduarit që ne përdorim gjatë të mësuarit.

Gjatë leksioneve, aftësitë e të menduarit shpeshherë zhvillohen në nivelin më të ulët të

taksonomisë, për shembull, në ato të të mbajturit mend dhe të kuptuarit. Aftësitë e larta të

të menduarit jo rrallë anashkalohen.

Për këtë arsye është e nevojshme të bëhen rregullimetë reja në fushën e të mësuarit, për të nxitur aftësitë që ndodhen në nivelet e larta të

taksonomisë, për shembull:

- të mësuarit në bashkëpunim,
- të mësuarit përmes zgjidhjes së problemit,
- të mësuarit përmes punës me projekt,
- harmonizimi i të mësuarit të pavarur në shtëpi me punën në klasë,
- të mësuarit përmes zgjidhjes krijuese të problemit,
- të mësuarit përmes kërkimit,
- të mësuarit përmes lojërave të simuluar

Ndonëse këto formate shpjegohen lehtësisht, zbatimi i tyre, megjithatë, është sfidues, si për nxënësit, ashtu edhe për mësuesit. Ato janë të vështirë për t'u mësuar dhe për t'u zbatuar në mënyrë individuale dhe pa përpjekjet e duhura. (Bloom, B.S., 1975)

Kapitulli III

4. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

4.1 Problemi i hulumtimit

Zhvillimi i vrullshëm i shoqërisë së sotme, rritja e informacionit, mjetet e shumëllojëshme të transmetimit kanë bërë të mundur që mësimdhënia të ndryshojë.

Në mësimdhënie është shumë e rëndësishme përzgjedhja dhe përdorimi i metodave që do të përdoren mësimdhënësi. Mësuesi duhet ta bëjë mësimin sa më interesant në klasë, të ketë dinamikë.

Përdorimi i drejtë metodave mësimore ndikon në zhvillimin e aftësive të buta të nxënësit dhe njëkohësisht ndikojnë në formimin e personalitetit të nxënësve, duke i aftësuar dhe përgatitur ata për jetë dhe punë, sidomos për vet arsimim dhe vetë mësim.

4.2 Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është analiza e aplikimit të metodave të mësimdhënies që ndihmojnë zhvillimin e shkathtësive të buta (komunikimit dhe mendimit kritik) të nxënësve gjatë shtjellimit të përmbajtjeve mësimore, dhe ndikimi i tyre arrijtjen e rezultateve të të nxënit.

Hulumtimi paraqet një pasqyrë se sa u ofrojnë mësimdhënësit - nxënësve metodologji efektive të organizmit të një ore mësimore cila e nxit zhvillimin e aftësive komunikuese dhe aftësitë e mendimit kritik të nxënësve.

Që të kemi një pasqyrë të këtyre rezultateve hulumtimi në fjalë, konstaton efektet që sjellin metodat e mësimdhënies gjatë procesit të vazhdueshëm në mësimnxënie, analizon përceptimet e mësimdhënësve për metodat adekuate, nxjerr përfundimet dhe jep rekomandimet rreth kësaj çështje bazuar në rezultate.

4.3 Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat

Pyetjet e hulumtimit:

1. Pse është i rëndësishëm zhvillimi i të menduarit kritik në shkollë?
2. Cilat janë mënyrat për të zhvilluar aftësinë e të menduarit kritik në mësimdhënie?
3. Përmes metodave mësimore adekuate a mund evidentohen vëshirësitë rreth nxitjes së mendimit kritik?

Hipotezat:

H1: Aplikimi i metodave të ndryshme mësimore kontribuon në ngritjen e mendimit kritik tek nxënësit e shkollave fillore.

H2: Produktiviteti i mendimit kritik varet nga lloji i mësimdhënies, metodat, teknikat dhe strategjitë që aplikon mësimdhënësi.

H3: Për të nxitur të menduarit, mësimdhënësi zbaton metoda të ndryshme ndërvepruese në klasë

4.4 Pjesëmarrësit dhe mostra

Në mënyrë që mostra të jetë sa më gjithëpërfshirëse, në hulumtim janë përfshirë të 40 mësimdhënës të arsimit fillor klasave II-V-ta, të shkollave publike në komunën e Ferizajt.

përkatesisht SHFMU “Vëllëzërit Jashari”, SHFMU “Gjon Sereqi”, SHFMU “Tefik Canka” dhe SHFMU “Jeronim De Rada”.

Për hulumtim kemi shfrytëzuar pyetësorin e të përbërë nga gjithsej 15 pyetje.

4.5 Procedurat e hulumtimit

Për realizimin e hulumtimit fillimisht është kërkuar miratimi nga udhëheqësit e shkollave dhe pajtimi nga palët pjesëmarrëse. Pas miratimit për plotësimin e pyetësorëve, pjesëmarrësve u është shpjeguar në detaje për ecurinë e hulumtimit.

Të gjithëve u është bërë e ditur se të dhënat do të analizohen dhe do të mbeten krejtësisht konfidenciale dhe se këto të dhëna do të përdoren vetëm për qëllime studimi.

Procedura e mbledhjes së të dhënave të pyetësorit, është planifikuar të zhvillohet në mënyrë fizike, shpërndarja e pyetësorëve të mesimdhënësve është bërë përmes grupeve të mesimdhënësve duke iu nënshtruar të gjitha kritereve etike dhe profesionale. Kohëzgjatja e nevojshme për plotësimin e pyetësorëve ka zgjatur rreth 10-15 minuta.

Gjatë prodhimit të të dhënave, kam bërë të mundur që të sigurohen udhëzime të nevojshme dhe të hollësishme për plotësimin e pyetësorit, në mënyrë që të anketuarit ta kenë të lehtë për ta kuptuar dhe plotësuar pyetësorin.

4.6 Analiza e të dhënave

Për ta hulumtuar në mënyrë shumë dimensionale përdorimin dhe ndikimin e metodave të mësimdhënies në zhvillimin e aftësive komunikuese dhe të menduarit kritik në arsimin fillor, janë përdorur metoda sasiore dhe cilësore të hulumtimit. Metoda sasiore (kuantitative) na ka ndihmuar për të shfaqur nivelin e zbatimit të mësimdhënies me nxënësin në qendër dhe nxitjen e mendimit kritik.

Përmes metodës së analizës teorike është bërë zbërthimi teorik i literaturës së shfytëzuar nga autorë të ndryshëm.

Mësimdhënësit pjesëmarrës janë zgjedhur me anë të proceseve të kampionimit të rastësishëm. Pyetësorët janë realizuar, me anë të programit aplikativ Microsoft Excel, ndërsa analiza e të dhënave cilësore është bërë përmes analizës tematike.

Me përdorimin e metodës statistikore janë përpunuar të dhënat dhe janë nxjerrë rezultatet e hulumtimit, të cilat janë paraqitur në mënyrë grafike.

Rezultatet e fituara janë paraqitur si numra dhe përqindje, për të pasur një pasqyrë sa më të qartë dhe kuptimplotë të statistikave të paraqitura. Karakteristikat e tilla si përqindja (Percentage), mesatarja aritmetike (Mean), mediani, moda, dhe devijimi standard (Standard Deviation), janë pjesë dominuese e shumicës së pohimeve në fletëpyetësor.

5. REZULTATET E HULUMTIMIT

Bazuar në rrjedhën e hulumtimit gjatë mbledhjes së të dhënave dhe analizës së tyre, mund të them që i gjithë ky proces është zhvilluar në mënyrë të rregullt.

Fillimisht janë hartuar instrumenti përkatës, me anë të të cilit janë mbledhur të dhënat e fituara.

Më pas është bërë shpërndarja e instrumentit të pyetësorit, për të vazhduar më tej me mbledhjen e të dhënave tjera shtesë si dhe realizimi i intervistimit bazuar në protokolin e përcaktuar. Hulumtimi është realizuar në komunën e Ferizajit, në muajt shkurt dhe mars ishte koha gjatë së cilës është bërë mbledhja e të dhënave.

Hulumtimi në përgjithësi dhe të dhënat në veçanti janë realizuar duke iu përmbajtur të gjitha parimeve të përcaktuara profesionale.

Në vazhdim do të prezantohen të dhënat demografike, në bazë të shpërndarjes së mostrës si dhe rezultatet e analizës sasiore dhe cilësore të hulumtimit.

5.1 Të dhënat demografike

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat demografike të mësimeve sipas gjinisë, grupmoshës, nivelit të kualifikimit dhe ndjekjes së trajnimeve për zhvillimin e aftësive të mendimit kritik.

Shpërndarja e mostrës së mësimeve sipas të dhënave demografike

Gjinia		Mashkull	Femër		Gjithsej		
	N	8	32		40		
	%	20	80		100		
Grupmosha		25-30	31-40		41-50	mbi 50	
	N	2	9	11	18		40
	%	5	22.5	27.5	45		100
Përvojë në mësime (vite)		0-2	3-5	6-10	11-15	mbi 15	
	N	1	0	6	9	24	40
	%	2.5	0	15	22.5	60	100
Shkalla e fundit e kualifikimit		Bachelor	Master				
	N	30	10		40		
	%	75	25		100		
Ndjekja e trajnimeve për zhvillimin e aftësive të mendimit kritik		Po	Jo				
	N	36	4		40		
	%	90	10		100		

Table 2 Të dhënat demografike të mësimeve

Në mostrën e mësimeve janë përfshirë gjithsej 40 mësime të ciklit fillor të shkollave publike të komunës së Ferizajit, 8 prej tyre i përkasin gjinisë mashkullore përkatësisht 20% dhe 32 të tjerë i përkasin gjinisë femërore përkatësisht 80%.

Sa i përket moshës së pjesëmarrësve në hulumtim, nga tabela vërejmë se 2 mësime apo 5% i përkasin grupmoshës 25-30 vjeç, e cila ishte edhe grupmosha me përqindjen më të vogël në krahasim

me grupmoshat tjera, 9 mësimdhënës apo 22.5% e tyre grupmoshës 31-40 vjeç, 11 mësimdhënës apo 27.5% e tyre 41-50 vjeç dhe 18 mësimdhënës ose 45% grupmoshës mbi 50 vjeç.

Pra, nga pjesëmarrësit në hulumtim shohim se numri më i madh i tyre i takon grupmoshës 41-50 dhe mbi 50 vjeç ndërsa, nën moshën 25 vjeç nuk është deklaruar asnjëri nga pjesëmarrësit.

Përvoja e punës varionte prej 0 deri mbi 15 vjet. Me 0-2 vite përvojë pune në mësimdhënie u deklarua vetëm 1 mësimdhënës apo 2.5%, njëkohësisht ishte përqindja më e vogël në krahasim me alternativat e tjera. Përvojë pune me 3-5 vite nuk u deklarua asnjë mësimdhënës dmth 0%.

Me 6-10 vite përvojë pune ishin 6 mësimdhënës pjesëmarrës apo 15.0%, me 11-15 vite përvojë pune ishin 9 apo 22.5% mësimdhënës dhe me mbi 15 vite u deklaruan 24 mësimdhënës apo 60%.

Nga të dhënat shihet se mësimdhënësit pjesëmarrës në hulumtim me një përqindje më të madhe ishin ata që kishin mbi 15 vite përvojë pune në mësimdhënie.

Të anketuarit u përkisnin dy niveleve të kualifikimit. Me kualifikim të nivelit bachelor u deklaruan 30 mësimdhënës apo 75%, ku njeherit ishte edhe përqindja më e madhe në krahasim me kualifikimet e tjera. Me kualifikimin master u deklaruan 10 mësimdhënës ose 25%, ndërsa me nivelin e fundit të kualifikimit doktoratë nuk pati asnjë të deklaruar. Mësimdhënësit për ndjekjen e trajnimeve për zhvillimin e aftësive të mendimit kritik të nxënësve u përgjigjën më shumë pozitivisht, 36 prej tyre apo 90%, kurse vetëm 4 mësimdhënës apo 10% deklaruan se nuk kishin ndjekur trajnime të tilla.

5.2. Të dhënat sasiore

Të dhënat sasiore të hulumtimit janë mbledhur duke shfrytëzuar pyetësin për mësimdhënës i cili ishte i ndarë në dy pjesë, ku pjesa e parë kishte për qëllim marrjen e të dhënave demografike kurse pjesa e dytë në formë deklaratah kishte për qëllim për të marrë të dhënat lidhur me planifikimin, zbatimin dhe ndikimin e metodave mësimore në zhvillimin e aftësive komunikuese dhe mendimit kritik.

Të dhënat e mbledhura në këtë hulumtim janë analizuar duke përdorur teknikat për analizë statistikore përshkruese

Nr.	Pohimet	Asnjëherë	Rrallë	Nganjëherë	Shpesh	Gjithmonë	Mesatarja aritmetike	Moda	Devijimi standard
1.	Gjatë planifikimit të orës mësimore përfshij edhe aktivitete që zhvillojnë komunikimin dhe mendimin kritik.	N			19	21	4.5	5.0	0.5
		%			47.5	52.5			
2.	Metodat mesimore nxisin mendimin kritik, kreativitetin dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve	N			16	24	4.6	5.0	0.5
		%			40.0	60.0			
3.	Metoda e bashkëpunimit rrit nivelin e komunikimit midis nxënësve.	N		1	20	19	4.5	4.0	0.6
		%		2.5	50.0	47.5			
4.	Krahasoj arritjet e nxënësve të mi për të parë ndikimin e strategjive dhe metodave të mësimdhënies.	N		4	21	15	4.3	4.0	0.6
		%		10.0	52.5	37.5			
5.	Shfrytëzoj rezultatet e metodës së dialogut për të përmirësuar zhvillimin e aftësive të buta të nxënësit.	N		3	12	25	4.6	5.0	0.6
		%		7.5	30.0	62.5			
6.	Shkolla jonë plotëson kushtet infrastrukturore për aplikimin e metodave mësimore.	N	2	4	17	17	4.2	4.00 ^a	0.8
		%	5.0	10.0	42.5	42.5			
7.	Jap të gjithë nxënësve informata kthyesë për të nxënit e tyre gjatë orës mësimore.	N	1	3	21	15	4.3	4.0	0.7
		%	2.5	7.5	52.5	37.5			
8.	Identifikoj vështirësitë me të cilat ballafaqohen nxënësit gjatë aplikimit të metodave të mësimdhënies përmes informatës kthyesë.	N		6	18	16	4.3	4.0	0.7
		%		15.0	45.0	40.0			

8.	Identifikoj vështirësitë me të cilat ballafaqohen nxënësit gjatë aplikimit të metodave të mësimdhënies përmes informatës kthyese.	N			6	18	16	4.3	4.0	0.7
		%			15.0	45.0	40.0			
9.	Nxënësit qartësojnë idetë e tyre për qëllimet e të nxënit dhe mendimin kritik përmes aplikimit të metodave të mësimdhënies.	N			8	19	13	4.1	4.0	0.7
		%			20.0	47.5	32.5			
10.	Metoda demonstrative ndihmon nxënësit më të dobët sepse i jep mundësi të shohin aktivitete praktike më të avancuar.	N		1	4	17	18	4.3	5.0	0.8
		%		2.5	10.0	42.5	45.0			
11.	Nxënësit fitojnë ide më të qarta se si t'i ndihmojnë vetes për t'u përmirësuar përmes komunikimit.	N			4	24	12	4.2	4.0	0.6
		%			10.0	60.0	30.0			
12.	Shprehitë komunikues u ndihmojnë nxënësit të korigjojnë njohuritë e tyre momentale, lëshimet dhe gabimet gjatë të nxënit.	N			4	18	18	4.4	4.00 ^a	0.7
		%			10.0	45.0	45.0			
13.	Nxënësit mësojnë më shumë kur parashtroj pyetje më shpesh gjatë përcjelljes së përparimit dhe kontrollimit të të kuptuarit.	N				16	24	4.6	5.0	0.5
		%				40.0	60.0			
14.	Parashtrimi i pyetjeve nxit tek nxënësit të menduarit e nivelit të lartë.	N				11	29	4.6	5.0	0.6
		%				27.5	72.5			
15.	Metoda e demonstrimit nxit dëshirën dhe përkushtimin e nxënësve si dhe orientojnë ata për arritjen e rezultateve të të nxënit.	N			1	16	23			
		%			2.5	40.0	57.5			

Table 3 Analiza përshkruese (frekuenca, përqindja, mesatarja aritmetike, moda dhe devijimi standard) e të dhënave nga mësimdhënësit.

Në vazhdim do të bëjmë analizën përshkruese të mostrës së mësimdhënësve. Bazuar në të dhënat e fituara nga analiza përshkruese për aplikimin e metodave të mësimdhënies, për ndikimin e tyre në zhvillimin e aftësive të komunikimit dhe mendimit kritik, mund të shohim se mësimdhënësit në përgjithësi në shumicën prej përgjigjeve të dhëna pohojnë se aplikojnë metoda të mësimdhënies ku me përdorimin e tyre ka ndikim pozitiv tek nxënësit. Kjo dëshmohet nga zgjedhja më e shpeshtë e alternativës “gjithmonë” dhe “shpesh” në pothuajse të gjitha përgjigjet.

Në pohimin e parë të pyetësorit të administruar te mësimdhënësit *“Gjatë planifikimit të orës mësimore përfshij edhe aktivitete që zhvillojnë komunikimin dhe mendimin kritik”*, 21 mësimdhënës të anketuar apo 52.5% u deklaruan për alternativën gjithmonë dhe 19 mësimdhënës apo 47% e tyre u deklaruan për alternativën shpesh, ndërsa për alternativat nganjëherë, rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është $M=4.5$ dhe devijimi standard $DS=0.5$. Të dhënat e fituara të këtij pohimi vërtetojnë se pjesa dërmuese e mësimdhënësve përfshijnë aktivitete që zhvillojnë aftësitë të buta si pjesë përbërëse të planifikimit mësimor.

Përfshirja e aktiviteteve që mundësojnë zhvillimin e aftësive komunikuese, rritjen e komunikimit ndërmjetë nxënësëve, përgjigjet e mësuesëve, do të përdoren për vlerësim, përcaktimin e kampionit, përzgjedhjen e procedurave të analizës së të dhënave dhe caktimin e një orari veprimesh.

Në pohimin e dytë *“Metodat mësimore nxisin mendimin kritik, kreativitetin dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve”*

24 mësimdhënës apo 60% e mësimdhënësve u deklaruan për alternativën gjithmonë dhe 16 mësimdhënës apo 40% u deklaruan për alternativën shpesh, e për alternativat nganjëherë, rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është $M=4.6$ dhe devijimi standard $DS=0.5$. Këto të dhëna të këtij pohimi tregojnë se në shkollat tona mësimdhënësit vlerësojnë rëndësinë e metodave mësimore që janë për t’u shërbyer nevojave praktike të të nxënit. Metodat mësimore janë thelbësore për zhvillimin e mendimit kritik, kreativitetit dhe aftësive për zgjidhjen e problemeve tek nxënësit

Pohimit të tretë *“Metoda e bashkëpunimit rrit nivelin e komunikimit midis nxënësëve”*

19 mësimdhënës të anketuar apo 47.5% u deklaruan për alternativën gjithmonë, 20 mësimdhënës apo 50% u deklaruan për alternativën shpesh dhe vetëm 1 mësimdhënës apo 2.5% u deklarua për alternativën nganjëherë, kurse për alternativat rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është $M=4.5$ dhe devijimi standard $DS=0.6$. Nga këto rezultate mund të themi me bindje të thellë se mësimdhënësit

pajtohen që metoda e bashkëpunimit rrit nivelin e komunikimit ndërmjetë nxënësëve dhe nxënia bëhet më cilësore. Kjo metodë i inkurajon ata të punojnë së bashku për të arritur qëllime të përbashkëta, të ndajnë ide dhe të përfshihen në diskutime që stimulojnë mësimin dhe zhvillimin e aftësive sociale dhe komunikative.

Në pohimin e katërt “Krahasoj arritjet e nxënësve të mi për të parë ndikimin e strategjive dhe metodave të mësimdhënies”

15 mësimdhënës të anketuar apo 47.5% u deklaruan për alternativën gjithmonë, 21 mësimdhënës apo 52.5% u deklaruan për alternativën shpesh dhe 4 mësimdhënës apo 10% e të anketuarve u deklaruan për alternativën nganjëherë e për alternativat rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është $M=4.3$ dhe devijimi standard $DS=0.6$. Nga këto të dhëna përfundojmë se mësimdhënësit vlerësojnë produktivitetin e nxënësëve, me qëllim që të kuptojnë cilësinë e arritjeve të nxënësve, pas aplikimit të metodave mësimore. Për ta plotësuar këtë proces ata analizojnë dhe krahasojnë rezultatet e vlerësimit të një njësie mësimore, të një teme, të një lënde apo të një fushe përgjatë një ore, një periudhe, viti apo shkalle për të arriturat që kanë treguar nxënësit. Natyrisht një analizë e tillë do të shërbejë për të parë nëse jemi duke përdorur strategjitë dhe teknikat e duhura të vlerësimit.

Në pohimin e pestë “Shfrytëzoj rezultatet e metodës së dialogut për të përmirësuar zhvillimin e aftësive të buta të nxënësit”

25 mësimdhënës të anketuar apo 62.5% u deklaruan për alternativën gjithmonë, 12 mësimdhënës apo 30% e të anketuarve u deklaruan për alternativën shpesh dhe 3 mësimdhënës apo 7.5% u deklaruan për alternativën nganjëherë, kurse për alternativat rrallë dhe asnjëherë as në këtë pohim nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është $M=4.6$ dhe devijimi standard $DS=0.6$. Këto rezultate tregojnë se mësimdhënësit e shkollave tona shfrytëzojnë rezultatet e metodës së dialogut, që të identifikojnë gabimet, të metat dhe vështësitë në zhvillimin e aftësive të buta, me qëllim që t’u ofrojnë ndihmë. Në këtë mënyrë ata mbikëqyrin ecurinë, procesin, përparimin e nxënësve, si dhe sigurojnë informatë kthyesë për të sjellë përmirësime. Kontrollonjë përparimin e nxënies së nxënësve gjatë procesit mësimor dhe shkallën e zhvillimit të aftësive të tyre.

Në pohimin e gjashtë ‘‘Shkolla jonë plotëson kushtet infrastrukturore për aplikimin e metodave mësimore’’

17 mësimdhënës të anketuar apo 42.5% u deklaruan për alternativën gjithmonë, gjithashtu edhe për alternativën shpesh u deklaruan 17 mësimdhënës apo 42.5%, ndërsa 4 mësimdhënës apo 10% u deklaruan për alternativën nganjëherë dhe 2 mësimdhënës apo 5% e të anketuarve u deklaruan për alternativën rrallë, kurse për alternativën asnjëherë nuk pati asnjë të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është $M=4.2$. dhe devijimi standard $DS=0.8$.

Përqindjet e dhëna nga rezultatet janë më të vogla në krahasim me pritshmëritë që kemi pasur lidhur me këtë pohim sepse vetem 17 mesimdhënes deklaruan qe shkolla është e pajisur për të zbatuar metoda që kërkojnë mundësi teknologjike, ambiente fleksibile, dhe mundësi të tjera për mësim dhe angazhim aktiv të nxënësve e dihet qartë që infrastruktura shkollore është faktor i rëndësishme që, ndihmon aplikimin e metodave të mësimdhënies e që u ndihmojnë mësimdhënësëve t’i identifikojnë pikat e forta dhe të dobëta të nxënësve gjatë procesit të të nxënës.

Në pohimin e shtatë ‘‘Jap të gjithë nxënësve informata kthyesë për të nxënësit e tyre gjatë orës mësimore’’

15 mësimdhënës apo 37.5% e të anketuarve u deklaruan për alternativën gjithmonë, 21 mësimdhënës apo 52.5% u deklaruan për alternativën shpesh, 3 mësimdhënës apo 7.5% u deklaruan për alternativën nganjëherë, vetëm 1 mësimdhënës apo 2.5% u deklarua për alternativën rrallë, ndërsa për alternativën asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është $M=4.3$ dhe devijimi standard $DS=0.7$. Nga kjo kuptojmë që një pjesë e madhe e tyre konsiderojnë që duke dhënë informata kthyesë (feedback) gjatë orës mësimore, mund të ndihmosh nxënësit të kuptojnë se si mund të përmirësohen dhe të rrisin angazhimin e tyre.

Në pohimin e tetë, ‘‘Identifikoj vështirësitë me të cilat ballafaqohen nxënësit gjatë aplikimit të metodave të mësimdhënies përmes informatës kthyesë.’’

16 mësimdhënës të anketuar apo 40% u deklaruan për alternativën gjithmonë, 18 mësimdhënës apo 45% e të anketuarve u deklaruan për alternativën shpesh, 6 mësimdhënës apo 15% u deklaruan për alternativën nganjëherë, ndërsa për alternativat rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është $M=4.3$ dhe devijimi standard $DS=0.7$. Në bazë të kësaj ne mund të përfundojmë se mësimdhënësit në një nivel të lartë vlerësojnë procesin e të nxënës, me qëllim që të kuptojnë se si nxënësit mësojnë, çfarë ata dinë dhe janë në gjendje të bëjnë, e jo vetëm për të matur sasinë dhe cilësinë e arritjeve të nxënësve

Për ta plotësuar këtë proces ata u komentojnë dhe i njoftojnë nxënësit për të arriturat që kanë treguar gjatë orës mësimore. Natyrisht një vlerësim i tillë do të shërbej si nxitje për të nxënit e vazhdueshëm.

Në pohimin e nëntë “Nxënësit qartësojnë idetë e tyre për qëllimet e të nxënit dhe mendimin kritik përmes aplikimit të metodave të mësimdhënies.”

13 mësimdhënës të anketuar apo 32.5% u deklaruan për alternativën gjithmonë, 19 mësimdhënës apo 47.5% u deklaruan për alternativën shpesh dhe 8 mësimdhënës apo 20% u deklaruan për alternativën nganjëherë, kurse për alternativat rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është $M=4.1$ dhe devijimi standard $DS=0.7$. Përqindjet e tilla të mesimdhënësve tane konsiderojnë që aplikimi i metodave është një qasje shumë e efektshme për të rritur angazhimin dhe zhvillimin e aftësive të nxënësve, duke i ndihmuar ata të reflektiojnë mbi procesin e të nxënit dhe të zhvillojnë mendimin kritik.

Në pohimin e dhjetë “Metoda demonstrative ndihmon nxënësit më të dobët sepse i jep mundësi të shohin aktivitete praktike më të avancuar”

18 mësimdhënës të anketuar apo 45% u deklaruan për alternativën gjithmonë, 17 mësimdhënës apo 42.5% u deklaruan për alternativën shpesh, 4 mësimdhënës apo 10% u deklaruan për alternativën nganjëherë dhe vetëm 1 mësimdhënës apo 2.5 % u deklarua për alternativën rrallë, kurse për alternativën asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është $M=4.3$ dhe devijimi standard $DS=0.8$. Rezultatet e këtyre dy pohimeve tregojnë se mësimdhënësit mendojnë që përdorimi i metodës demonstrative është një mënyrë shumë e fuqishme për të ndihmuar nxënësit, veçanërisht ata që mund të kenë vështirësi në përvetësimin e teorisë, sepse kjo metodë u mundëson atyre të shohin se si realizohen aktivitete praktike.

Në pohimin e njëmbëdhjetë “Nxënësit fitojnë ide më të qarta se si t’i ndihmojnë vetes për t’u përmirësuar përmes komunikimit”

12 mësimdhënës të anketuar apo 30% u deklaruan për alternativën gjithmonë, 24 mësimdhënës apo 60% u deklaruan për alternativën shpesh dhe 4 mësimdhënës apo 10% u deklaruan për alternativën nganjëherë, ndërsa për alternativat rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është $M=4.2$ dhe devijimi standard $DS=0.6$. Këtu kuptojmë që mësimdhënësit i japin rëndësi komunikimit ngase komunikimi

i hapur dhe reflektiv i mundëson atyre të shprehin mendimet, ndjesitë dhe vështirësitë që hasin gjatë mësimi.

Në pohimin e dymbëdhjetë “Shprehitë komunikues u ndihmojnë nxënësit të korigjojnë njohuritë e tyre momentale, lëshimet dhe gabimet gjatë të nxënësve”.

18 mësimdhënës të anketuar apo 45% u deklaruan për alternativën gjithmonë, 18 mësimdhënës apo 45% u deklaruan për alternativën shpesh dhe 4 mësimdhënës apo 10% u deklaruan për alternativën nganjëherë, ndërsa për alternativat rrallë dhe asnjëherë as në këtë pohim nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është $M=4.4$ dhe devijimi standard $DS=0.7$. Bazuar në rezultatet e fituara vërejmë se aftësitë komunikuese ndikojnë shumë tek nxënësit sepse si proces që është, mundëson që nxënësit të mbledhin informacione për veten e tyre dhe bëjnë gjykimin për vlerat e veta. Këtë vlerësim nxënësi e realizon duke krahasuar rezultatet e veta me rezultatet e nxënësve të tjerë.

Përshkrimi i shprehive komunikues si një mjet për të ndihmuar nxënësit të korigjojnë njohuritë e tyre momentale, lëshimet dhe gabimet është shumë i saktë dhe thelbësor në procesin mësimor.

Në pohimin e trembëdhjetë “Nxënësit mësojnë më shumë kur parashtroj pyetje më shpesh gjatë përcjelljes së përparimit dhe kontrollimit të të kuptuarit.”

24 mësimdhënës të anketuar apo 60% u deklaruan për alternativën gjithmonë dhe 16 mësimdhënës apo 40% u deklaruan për alternativën shpesh, kurse për alternativat nganjëherë, rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është $M=4.6$ dhe devijimi standard $DS=0.5$. Këtu arrijmë në përfundim që për mësimdhënësit tanë parashtrimi i pyetjeve gjatë mësimi, e shohin si një mjet për të monitoruar dhe përmirësuar kuptimin e nxënësve, ndihmon shumë në thellimin e njohurive të tyre dhe në zhvillimin e aftësive për të menduar kritikisht.

Në pohimin e katërbëdhjetë “Parashtrimi i pyetjeve nxit tek nxënësit të menduarit e nivelit të lartë” 29 mësimdhënës të anketuar apo 72.5% u deklaruan për alternativën gjithmonë dhe 11 mësimdhënës apo 27.5% u deklaruan për alternativën shpesh, kurse për edhe në këtë pohim nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar për alternativat nganjëherë, rrallë dhe asnjëherë. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është $M=4.6$ dhe devijimi standard $DS=0.6$. Rezultatet e fituara nga këto dy pohime tregojnë rëndësinë e parashtrimi të pyetjeve e sidomos rolin shumë të rëndësishëm të mësimdhënësit sepse “Të dish të bësh pyetje si duhet, do të thotë të dish të japësh mësim. Më shumë se çdo gjë tjetër, arti i bukur i mësimdhënies varet nga mjeshtëria

e përdorimit të pyetjeve” Pyetjet bëjnë pjesë në metodat e planifikimit të orës mësimore, pa të cilat procesi mësimor do të ishte shumë monoton dhe jo zbavitës për nxënësit. Përtej qëllimit kryesor që kanë, pyetjet mund të shërbejnë si një mënyrë për të rritur vetbesimin dhe aftësinë e nxënësve për të krijuar ata vetë pyetje mësuesit, duke mundësuar kështu një përfshirje aktive gjatë orës mësimore.


Në pohimin e pesëmbëdhjetë “Metoda e demonstrimit nxit dëshirën dhe përkushtimin e nxënësve si dhe orientojnë ata për arritjen e rezultateve të të nxënit”,

23 mësimdhënës të anketuar apo 57.5% u deklaruan për alternativën gjithmonë dhe 16 mësimdhënës apo 40% u deklaruan për alternativën shpesh, vetëm 1 mësimdhënës apo 2.5% u deklarua për alternativën nganjëherë, ndërsa për alternativat rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar.

Rezultatet e këtij pohimi të fundit në këtë pyetësor tregojnë se mësimdhënësit pohojnë që metoda e demonstrimit është shumë efektive për të nxitur dëshirën dhe përkushtimin e nxënësve, sepse ajo ofron një shembull të drejtpërdrejtë dhe të kuptueshëm të asaj që duhet bërë, duke i orientuar ata në mënyrë të qartë për arritjen e rezultateve të dëshiruara të të nxënit Kur mësuesi tregon në mënyrë praktike një aktivitet ose proces, nxënësit mund të shohin se si zhvillohet dhe si mund ta realizojnë vetë atë.

5.3 Të dhënat grafike


5.3.1 Grafika e të dhënave demografike të mësimeve.



Grafiku 1. Gjinia e mësimeve

Në mostrën e mësimeve janë përfshirë gjithsej 40 mësime ku 20% i përkasin gjinisë mashkullore dhe 32 të tjerë i përkasin gjinisë femërore përkatësisht 80%.


Kjo është përparësi ngase mësueset femra shpesh janë të njohura për aftësitë e tyre sociale dhe emocionale, dhe mund të luajnë një rol të veçantë në mbështetje emocionale për nxënësit, shpeshherë mësueset femra janë shpesh modele të rëndësishme për nxënësit, veçanërisht për vajzat.



Grafiku 2. Grupmosha e mësimehënësëve


Sa i përket moshës së pjesëmarrësve në hulumtim, nga tabela vërejmë 5% e mësimehënës përkasim grupmoshës 25-30 vjeç, e cila ishte edhe grupmosha me përqindjen më të vogël në krahasim me grupmoshat tjera, 22.5% e tyre grupmoshës 31-40 vjeç, 28% e tyre 41-50 vjeç dhe 45% e mësimehënësëve grupmoshës mbi 50 vjeç.

Pra, nga pjesëmarrësit në hulumtim shohim se numri më i madh i tyre i takon grupmoshës 41-50 dhe mbi 50 vjeç ndërsa, nën moshën 25 vjeç nuk është deklaruar asnjëri nga pjesëmarrësit.



Grafiku 3. Përvoja e mësimehënësëve

Nga grafiku shohim që përvoja e punës varionte prej 0 deri mbi 15 vjet, dhe përvoja më dominuese është ajo e moshës mbi 15 vite, që nënkupton që nxënësit janë me mësimehënës profesionist që kanë një bagazh shumë të madh të përvojës. Mësuesit më të përvojshëm kanë mundësinë të përmirësojnë aftësitë e menaxhimit të klasës, të krijojnë një ambient pozitiv dhe motivues për nxënësit



Grafiku 4. Niveli i shkollimit të mësimeve

Të anketuarit u përkisnin dy niveleve të kualifikimit. me kualifikim të nivelit bachelor u deklaruan 75% e mësimeve ku njëherit ishte edhe përqindja më e madhe në krahasim me kualifikimin master. Me kualifikimin master u deklaruan 25% të mësimeve




Grafiku 5. Ndjekja e trajnimeve të mësimeve

Ndjekja e trajnimeve për zhvillimin e aftësive të buta të nxënësit, mësuesit u përgjigjën më shumë pozitivisht, ku 90% kishin trajnime, kurse vetëm 10% të mësimeve deklaruan se nuk kishin ndjekur trajnime të tilla. Mësuesit që ndjekin trajnimet janë më të aftë të krijojnë mjedise mësimore që nxisin angazhimin dhe suksesin e nxënësit.

5.3.2 Grafika e të dhënave nga pyetësi.

Pohimi:

Gjatë planifikimit të orës mësimore përfshij edhe aktivitete që zhvillojnë komunikimin dhe mendimin kritik




Grafiku 6. Përfshirja e aktiviteteve në orë mësimore.

52.5% të mësimdhënësëve u deklaruan për alternativën **gjithmonë** dhe 19 mësimdhënës apo 47% e tyre u deklaruan për alternativën **shpesh**, ndërsa për alternativat **nganjëherë**, **rrallë** dhe **asnjëherë** nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar.

Nga kjo kuptojmë që pjesa më e madhe e tyre përfshirjen e aktiviteteve për zhvillimin e mendimit kritik e shohin të rëndësishme ngase aktivitetet inkurajojnë nxënësit të angazhohen me njëri-tjetrin dhe të diskutojnë idetë janë thelbësore për zhvillimin e mendimit kritik dhe aftësive të komunikimit.

Pohimi:

Metodat mësimore nxisin mendimin kritik, kreativitetin dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve



Grafiku 7. Rezultatet e metodat mësimore për nxitjen e aftësive të buta


Nga grafiku del që 60% e mësimeve u deklaruan për alternativën **gjithmonë** dhe 40% u deklaruan për alternativën **shpesh**, e për alternativat **nganjëherë**, **rrallë** dhe **asnjëherë** nuk pati asnjë të deklaruar.

Nga grafiku vërehet qartë shpeshësia e përdorimit të metodave që kanë për qëllim afirmimin e pozitës në qendër të klasës të nxënësve. Me deklaratimet e tyre mësimeve na bindin se u ofrojnë nxënësve mundësi për të zhvilluar mendimin kritik, ku njehohësisht shohim plotësimin e hipotezës së parë ku thot:

H1: Aplikimi i metodave të ndryshme mësimore kontribuon në ngritjen e mendimit kritik tek nxënësit e shkollave fillore.

Pohimi:

Metoda e bashkëpunimit rrit nivelin e komunikimit midis nxënësëve




Grafiku 8. Rezultatet e metodës së bashkëpunimit

Nga grafiku shohim që 50% të mësimdhënësëve u deklaruan për alternativën **shpesh**, 48% u deklaruan për alternativën **gjithmonë** dhe 2% u deklarua për alternativën **nganjëherë**, kurse për alternativat **rrallë** dhe **asnjëherë** nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar.

Kjo dëshmon që mësimdhënësit metodën e bashkëpunimit e shohin si mundësi për nxënësit të ndihmojnë njëri-tjetrin dhe të ndërtojnë marrëdhënie miqësore dhe respektuese.

Pohimi:

Krahasoj arritjet e nxënësve të mi për të parë ndikimin e strategjive dhe metodave të mësimdhënies




Grafiku 9. Arritjet e nxënësve nën ndikimin e metodave të mësimdhënies

15 mësimdhënës të anketuar apo 47.5% u deklaruan për alternativën **gjithmonë**, 21 mësimdhënës apo 52.5% u deklaruan për alternativën **shpesh** dhe 4 mësimdhënës apo 10% e të anketuarve u deklaruan për alternativën nganjëherë e për alternativat rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Krahasimi i arritjeve të nxënësve u ndihmon mësuesit të kuptojnë se cilat qasje janë më të dobishme për nxënësit e tyre dhe t'i ndihmojnë ata të përmirësohen. Tek ky pohim shohim plotësimin e hipotezës së dytë:

H2: Produktiviteti i mendimit kritik varet nga lloji i mësimdhënies, metodat, teknikat dhe strategjitë që aplikon mësimdhënësi.

Pohimi:

Shfrytëzoj rezultatet e metodës së dialogut për të përmirësuar zhvillimin e aftësive të buta te nxënësit



Grafiku 10. Rezultatet e metodës së dialogut


62.5% të mësimdhënësëve u deklaruan për alternativën **gjithmonë**, 12 mësimdhënës apo 30% e të anketuarve u deklaruan për alternativën **shpesh** dhe 3 mësimdhënës apo 7.5% u deklaruan për alternativën **nganjëherë**, kurse për alternativat rrallë dhe asnjëherë as në këtë pohim nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar.

Përdorimi i metodës së dialogut është një mundësi shumë e mirë për të përmirësuar zhvillimin e aftësive të buta te nxënësit. Duke inkurajuar diskutime, bashkëpunim dhe mendim kritik, nxënësit mund të zhvillojnë aftësitë që janë thelbësore për suksesin e tyre në shkollë. Ketu vërejmë që është plotësuar hipoteza e trete ku thot:

H3: Për të nxitur të menduarit, mësimdhënësi zbaton metoda të ndryshme ndërvepruese në klasë

Pohimi:

Shkolla jonë plotëson kushtet infrastrukturore për aplikimin e metodave mësimore




Grafiku 11. Kushtet infrastrukturore të shkollës

17 mësimdhënës të anketuar apo 42.5% u deklaruan për alternativën **gjithmonë**, gjithashtu edhe për alternativën **shpesh** u deklaruan 17 mësimdhënës apo 42.5%, ndërsa 4 mësimdhënës apo 10% u deklaruan për alternativën **nganjëherë** dhe 2 mësimdhënës apo 5% e të anketuarve u deklaruan për alternativën **rrallë**, kurse për alternativën asnjëherë nuk pati asnjë të deklaruar.

Nje lloj ambienti me kushte infrastrukturore te mira mundëson që nxënësit të përfitojnë më shumë nga metodat mësimore dhe të arrijnë rezultate më të mira në të nxënit e tyre

Pohimi:

Jap të gjithë nxënësve informata kthyesë për të nxënëit e tyre gjatë orës mësimore



Grafiku 12. Informata kthyesë e mësimdhënëseve ndaj për nxënësit

37.5% e të anketuarve u deklaruan për alternativën **gjithmonë**, 21 mësimdhënëës apo 52.5% u deklaruan për alternativën **shpesh**, 3 mësimdhënëës apo 7.5% u deklaruan për alternativën **nganjëherë**, vetëm 1 mësimdhënëës apo 2.5% u deklarua për alternativën **rrallë**, ndërsa për alternativën asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënëës të deklaruar.

Dhënia e informacioneve kthyesë për nxënësit gjatë orës mësimore është një mundësi e shkëlqyer për t'i udhëzuar dhe inkurajuar ata në kohë reale.

Pohimi:

Identifikoj vështirësitë me të cilat ballafaqohen nxënësit gjatë aplikimit të metodave të mësimdhënies përmes informatës kthyesë.




Grafiku 13. Identifikimi vështirësive gjatë aplikimit të metodave të mësimdhënies

16 mësimdhënës të anketuar apo 40% u deklaruan për alternativën **gjithmonë**, 18 mësimdhënës apo 45% e të anketuarve u deklaruan për alternativën **shpesh**, 6 mësimdhënës apo 15% u deklaruan për alternativën **nganjëherë**, ndërsa për alternativat rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Identifikimi i vështirësive që mund të hasin nxënësit gjatë aplikimit të metodave të mësimdhënies përmes informacionit kthyes është një hap shumë i rëndësishëm për të përmirësuar procesin e të nxënësve

Pohimi:

Nxënësit qartësojnë idetë e tyre për qëllimet e të nxënit dhe mendimin kritik përmes aplikimit të metodave të mësimdhënies




Grafiku 14. Qartësimi i ideve të nxënësit nën ndikimin e metodave mësimore

13 mësimdhënës të anketuar apo 32.5% u deklaruan për alternativën **gjithmonë**, 19 mësimdhënës apo 47.5% u deklaruan për alternativën **shpesh** dhe 8 mësimdhënës apo 20% u deklaruan për alternativën **nganjëherë**, kurse për alternativat rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Përmes metodave të ndryshme mësimore, nxënësit mund të zhvillojnë mendimin e tyre kritik, të bëjnë pyetje dhe të kërkojnë përgjigje, si dhe të krijojnë lidhje midis ideve dhe koncepteve.

Pohimi:

Metoda demonstrative ndihmon nxënësit më të dobët sepse i jep mundësi të shohin aktivitete praktike më të avancuar




Grafiku 15. Rezultatet e metodës demonstrative

18 mësimdhënës të anketuar apo 45% u deklaruan për alternativën **gjithmonë**, 17 mësimdhënës apo 42.5% u deklaruan për alternativën **shpesh**, 4 mësimdhënës apo 10% u deklaruan për alternativën **nganjëherë** dhe vetëm 1 mësimdhënës apo 2.5 % u deklarua për alternativën **rrallë**, kurse për alternativën asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar.

Metoda demonstrative krijon një lidhje të drejtpërdrejtë midis njohurive dhe aplikimit të tyre, duke i ndihmuar nxënësit të zhvillojnë aftësi të reja dhe të përmirësojnë përvetësimin e materialeve mësimore.

Pohimi:

Nxënësit fitojnë ide më të qarta se si t'i ndihmojnë vetes për t'u përmirësuar përmes komunikimit




Grafiku 16. Ndikimi shkathtësive të komunikimit te nxënësit

12 mësimdhënës të anketuar apo 30% u deklaruan për alternativën **gjithmonë**, 24 mësimdhënës apo 60% u deklaruan për alternativën **shpesh** dhe 4 mësimdhënës apo 10% u deklaruan për alternativën **nganjëherë**, ndërsa për alternativat rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklarur. Mësimdhënësit pajtohen që komunikimi ndihmon nxënësit të vendosin qëllime të qarta dhe realiste për përmirësimin e tyre dhe të krijojnë strategji për të arritur ato.

Pohimi:

Shprehitë komunikues u ndihmojnë nxënësit të korigjojnë njohuritë e tyre momentale, lëshimet dhe gabimet gjatë të nxënës.




Grafiku 17. Ndikimi i shprehive komunikuese gjatë të nxënës

18 mësimdhënës të anketuar apo 45% u deklaruan për alternativën **gjithmonë**, 18 mësimdhënës apo 45% u deklaruan për alternativën **shpesh** dhe 4 mësimdhënës apo 10% u deklaruan për alternativën **nganjëherë**, ndërsa për alternativat rrallë dhe asnjëherë as në këtë pohim nuk pati asnjë mësimdhënës të deklarur.

Mësimdhënësit janë të pajtimit që përdorimi i komunikimit të hapur dhe të qartë me mësuesin dhe bashkëmoshatarët mund të ndihmojë nxënësit të identifikojnë dhe rregullojnë çfarëdo gabimi të mundshëm

Pohimi:

Nxënësit mësojnë më shumë kur parashtroj pyetje më shpesh gjatë përcjelljes së përparimit dhe kontrollimit të të kuptuarit




Grafiku 18. Ndikimi i parashtrimit të pyetjeve.

24 mësimdhënës të anketuar apo 60% u deklaruan për alternativën **gjithmonë** dhe 16 mësimdhënës apo 40% u deklaruan për alternativën **shpesh**, kurse për alternativat nganjëherë, rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar.

Parashtrhja e pyetjeve nga mësimdhënësit më shpesh gjatë procesit të mësimdhënies është një teknikë shumë efektive që ndihmon nxënësit të marrin një kuptim më të thellë dhe të përmirësojnë mësimin e tyre.

Pohimi:

Parashtrimi i pyetjeve nxit tek nxënësit të menduarit e nivelit të lartë




Grafiku 19. Nxitja e parashtrimi i pyetjeve

72.5% u deklaruan për alternativën **gjithmonë** dhe 11 mësimdhënës apo 27.5% u deklaruan për alternativën **shpesh**, kurse për edhe në këtë pohim nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar për alternativat nganjëherë, rrallë dhe asnjëherë.

Mësimdhënësit nxisin nxënësit të përdorin aftësitë e tyre të mendimit kritik, përmes pyetjeve që kërkojnë që ata të vlerësojnë informacionin duke ofruar mendime të arsyeshme dhe të mbështetura mirë mbi fakte dhe prova.

Pohimi:

Metoda e demonstrimit nxit dëshirën dhe përkushtimin e nxënësve si dhe orientojnë ata për arritjen e rezultateve të të nxënësve



Grafiku 20. Ndikimi i metodës së demonstrimit

23 mësimdhënës të anketuar apo 57.5% u deklaruan për alternativën gjithmonë dhe 16 mësimdhënës apo 40% u deklaruan për alternativën shpesh, vetëm 1 mësimdhënës apo 2.5% u deklarua për alternativën nganjëherë, ndërsa për alternativat rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar.

Mësimdhënësit pajtohen që pasi nxënësit shohin një demonstrim të suksesshëm, ata janë më të prirur të angazhohen në mësim dhe të ndihen të përfshirë në procesin e të nxënësve.

vi Përfundimi

Qëllimi i parë i studimit ishte që të shikohej si dhe sa zbatohen metodat e mësimdhënies për zhvillimin e aftësive të buta. Analiza e bërë tematike identifikoi tema të ndryshme të cilat karakterizojnë dhe përshkruajnë më mirë mësimdhënien me metoda bashkëkohore të mësimdhënies,

Të dhënat u mblodhën me anë të pyetësorit të hartuar për mësimdhënësit, dhe rezultatet u paraqitën së bashku me analizat.

Nga përpunimi statistikor i rezultateve si përfundim arritëm në vërtetimin e të tri hipotezave në të cilat parashikonin që aplikimi i metodave të ndryshme mësimore kontribuon në ngritjen e aftësive të komunikimit dhe të mendimit kritik tek nxënësit e shkollave fillore.

Përpunimi statistikor dhe prezantimi i rezultateve nga hulumtimi, lejojnë mundësinë e konkludimit afirmativ të tri hipotezave se shumica e mësimdhënësve në shkollën fillore pajtohen që produktiviteti i mendimit kritik varet nga metodat e mësimdhënies, teknikat dhe strategjitë që aplikon mësimdhënësi dhe më këtë ndihmojnë në nxitjen e mendimit kritik dhe aftësivë të komunikimit.

Andaj edhe unë si mësimdhënëse e ardhshme në fund të punimit erdha në përfundim që për zhvillimin e të menduarit kritik konsideroj që nga fillimi duhet aplikuar metoda të llojëllojshme mësimore, që këto aftësi zhvillohen qëllimisht, pastaj ato mund të sjellin një ndryshim të madh në cilësinë e komunikimit dhe mënyrën e të menduarit në jetën e përditshme.

Rekomandimet

- Të zhvillohet të menduarit kritik përmes metodave, teknikave dhe mundësive që ofron mësimdhënia bashkëkohore, të shfrytëzohen mjetet, materialet që janë në dispozicion, por edhe për ato që nuk janë në dispozicion të përkujdesen komunat për pajisjen e shkollave e mjete të ndryshme didaktike-metodike.
- Të përgatitën mësimdhënësit e rinjë që në studimet themelore që të planifikojnë, organizojnë dhe menagjojnë mësimin me nxënësin në qendër dhe nxitjen e mendimit kritik. Do të thotë të ketë së paku një kurs rreth çështjeve të lartëshënuara në programin studimor përkatës
- Duhet të organizohen trajnime të ndryshme me qëllim të informimit të mësimdhënësve për rëndësinë e përdorimit të metodologjive dhe teknikave bashkëkohore, gjithashtu edhe për t'i pajisur ata me kompetenca adekuate për organizimin e mësimin sa me interaktiv dhe më cilësor edhe për nxënësit.
- Duhet të organizohen trajnime të ndryshme me qëllim të informimit të mësimdhënësve për rëndësinë e përdorimit të metodologjive dhe teknikave bashkëkohore, gjithashtu edhe për t'i pajisur ata me kompetenca adekuate për organizimin e mësimin sa me interaktiv dhe më cilësor edhe për nxënësit
- Shkollat duhet të inkurajojnë mësimdhënësit që me anë të organizimit të garave të ndryshme, ekskurzioneve, organizimit të punës me projekte, ekspozita të ndryshme e të tjera metodologji që ndikojnë në nxitjen e mendimit kritik dhe aktualizimit të nxënësit në qendër.

VI. REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE

- Anderson, P.A, & Lynch, J. A. (2016). *Communication skills for elementary school students*. New York: Jossey-Bass.
- Balhysa, A. (2001). *Modele për mësimdhënie të suksesshme, Teknika për zhvillim të menduarit kritik*. Tiranë: EduALBA.
- Bloom, B.S. (1975). *taxonomy of Educational Objectives*. New York.
- Brada, B. (2005). *Pedagogjia parashkollore*. Prishtinë: Libri shkollor.
- Bryman, A. (2012). *Social Research Methods*. Oxford: University Press.
- Enciklopedia., P. (1989). Novi Sad.
- Fullan, M. (2001). *Kuptimi i ri i ndryshimit në arsim*. Tiranë: SOROS.
- Garro, S. (2011). *Metodologjia dhe praktika e mësimdhënies*. Tiranë: UFO Press.
- Gjuetia. (2011). Në V. Asllan, *Kosova* (f. 45). Prishtine: Dukagjini.
- Grillo, K. (2002). *Fjalor edukimi*. Tiranë: Dita.
- Grup autorësh. (2005). *Mësimdhënia me në qendër nxënësin (pjesa e parë)*. Tiranë: Geer.
- Hyseni.H, Mita.N, Salihaj.J, & D, P. (2003). *Qeverisja dhe udhëheqja në arsim*. Prishtinë: KEC.
- Ismajli, H. (2012). *Teknologjia mësimore dhe të menduarit kritik*. Prishtinë: Libri shkollor.
- KEC. (1998). *Strukturë për zhvillimin e mendimit kritik gjatë kurrikulumit*. Prishtinë: MKLSH.
- Maki, P. (2002). *Developing an Assessment Plan to Learn about Student Learning*. Washington.
- Miller, B . (2005). *Si të krijohet kontakti i suksesshëm me nxënësit*. Ferizaj: QPEA.
- Miller, B. (2003). *Si të krijohet kontakt i suksesshëm me nxënësit*. Ferizaj: QPEA.
- Musai, B . (2003). *Metodologji e mësimdhënies*. Tiranë: Pegi.
- Musai, B. (2003). *Metodologjia e mësimdhënies*. Tirane: Libri shkollor.
- Musai, B. (2003). *Të menduarit kritik: Çfarë është dhe çfarë mund të jetë?* Tiranë: Mprehtësi.
- Musai, B. ,. (2003). *Metodologji e mësimdhënies*. Tiranë: CDE.
- Musai, B. .. (2003). *Të menduarit kritik: Çfarë është dhe çfarë mund të jetë?* Tiranë: Mprehtësi.
- Musai, B. (2003). *() . Metodologji e msimdhënies. : . Metodologji e mësimdhënies*. Tiranë: CDE.
- Musai, B. (2003). *Metodologji e mësimdhënies*. Tiranë: Pegi.
- Musai, B. (2003). *Metodologji e mësimdhënies*. Tiranë: Pegi.
- Musai, B. (2003). *Metodologji e mësimdhënies. .* Tiranë: Pegi.
- Musai, B. (2003). *Metodologji e msimdhënies*. Tiranë: CDE.

- Musai, B. (2003). *Metodologjia e mësimdhënies*. Tiranë: PEGI.
- Musai, B. (2003). *Të menduarit kritik: Çfarë është dhe çfarë mund të jetë?* Tiranë: " Mprehtësi".
- Musai, B. (2003). *Të menduarit kritik: Çfarë është dhe çfarë mund të jetë?* Tiranë: Mprehtësi.
- Musai, B. (2003). *Të menduarit kritik: Çfarë është dhe çfarë mund të jetë?* Tiranë: Mprehtësi.
- Musai, B. (2004). *Zhvillimi i mendimit kritik*. Prishtinë: KEC.
- Musai, B. (2004). *Zhvillimi i mendimit kritik*. Prishtinë: KEC.
- Musai, B. (2004). *Zhvillimi i mendimit kritik*. Prishtinë: KEC.
- Musai,B. (2005). *MESIMDHENIA DHE TE NXENIT NDERVEPRUES*. Tirane: CDE.
- Musai. B. (2003). *Metodologjia e mësimdhënies*. Tiranë: PEGI.
- Musai. B. (2003). *Të menduarit kritik: Çfarë është dhe çfarë mund të jetë?* Tiranë: Mprehtësi.
- Padget, S. (2008). Creativity and critical thinking.
<https://www.steveslearning.com/Korean%20Resources/Creativity%20and%20Critical%20>
- Pattnaik .Ch, Ashok .Ch, Banerjee.Sh. (1986). *Methods of teching science, M.A EDUCATION*. Delhi.
- Qendra për Demokraci dhe Pajtim në Europën Juglindore. (2013). *Mësimdhënia e të mësuarit*. Beograd: Gama Digital Centar d.o.o.
- QTKA. (2005). *Mësimdhënia me në qendër nxënësin*. Tiranë.
- Rama, B. (2011). *Metodat e mësimdhënies dhe ndikimi i tyre në të nxënë*. Tiranë: Revista Pedagogjike.
- Rama,B. (2005). *Metodat e mësimdhënies dhe ndikimi i tyre në të nxënë*. Prishtine: Revista pedagogjike.
- Raçi,A & Kuqi,S. (2017). *Doracak i përgatitjes ditore për orën e msimit për mësimdhënie e mësimnxënie*. Pejë: Dugagjini.
- Simon, B. (1999). *Why no pedagogy in England?* London: Sage.
- Starkey, L. (2004). *Critical Thinking Skills Success*. New York: LearningExpress.
- Steele, J & Meredith,K & Temple,C. (1998). *Zhvillimi i mendimit kritik*. Tirane: CDE.
- Syla, X. (2017). *Gjuhë shqipe dhe letërsi 5. .* Prishtinë: Libri shkollor.
- Sylejmani, S. (2012). *Metodologji e mësimdhënie*. Prishtinë: Printing Press.
- Temple, C. (2006). *Strategji të mësimdhënies dhe të nxënit për klasat mendimtare. .* Tiranë: MKLSH.
- Trëndafil, G. (2008). *Metodologji dhe veprimtari,Të menduarit kritik dhe struktura"E.R.R*. Tiranë: DEART.
- Vrapi, A. (2015). *Mësimdhënia e diferencuar dhe ndikimi i saj në mësimnxënie në klasa*. Tirane: UET.
- Vrapi, A. (2015). *Mësimdhënia e diferencuar dhe ndikimi i saj në mësimnxënie në klasa*. Prishtine: Dugagjini.

- Vrapi, A. (2015). *Mësimdhënia e diferencuar dhe ndikimi i saj në mësimnxënie në klasa*. Tirane.
- Woolfolk, A. (2010). *Psikologji edukimi*. Tiranë: CDE.
- Wragg, T. (1997). *Assessment and Learning: Primary and Secondary*. London: Routledge.
- Wragg, T. (1997). *Assessment and Learning: Primary and Secondary*. London: Routledge.
- Zhitija-Gjelaj, M. (2011). *Roli i mësuesit në klasat me nxënësin në qendër*. Prishtinë: Libri shkollor.
- Zylfiu, N. (2004). *Didaktika*. Prishtinë: Libri shkollor.
- Zylfiu, N. (2004). *Didaktika*. Prishtinë: Libri shkollor.
- Zylfiu, N. (2011). *Teoria e mësimi dhe proceset didaktike të mësimdhënies*. Prishtinë: Printing Press.

Shtojca A – Pyetësi për mësimdhënës

Të nderuar mësimdhënës,

Ky pyetësor ka për qëllim grumbullimin e të dhënave nga mësimdhënësit e shkollave fillore të Komunës së Ferizajt, për nivelin e aplikimi i metodave të mësimdhënies në zhvillimin e aftësive komunikuese dhe të menduarit kritik në arsimin fillor

Përceptimet dhe përvojat tuaja do të jenë një kontribut i mirë dhe do të shërbejnë për çështje hulumtimi. Pyetësi është anonim dhe mbi të gjitha, të dhënat që do të mblidhen me këtë pyetësor, do të përdoren vetëm për qëllime studimi.

Faleminderit!

Informacione të përgjithshme									
1	Gjinia	Mashkull	☐			Femër	☐		
2	Mosha (vjeç)	Nën 25	☐	25-30	☐	31-40	☐	41-50	☐
3	Përvojë në mësimdhënie (vite)	0-2 ☐	☐	3-5 ☐	☐	6-10 ☐	☐	11-15 ☐	Mbi 15 ☐
4	Shkalla e fundit e kualifikimit tuaj	Bachelor ☐	☐	Master ☐	☐	Doktoratë ☐	☐		
5	A keni ndjekur trajnime ku është trajtuar tema e zhvillimit të mendimit kritik?						Po	☐	Jo
								☐	

Ju lutem zgjidhni vetëm një të një nga alternativat që përputhet me mendimin tuaj, duke vendosur ☒

Nr.	Pyetjet	Niveli				
		1	2	3	4	5
1.	Gjatë planifikimit të orës mësimore përfshij edhe aktivitete që zhvillojnë komunikimin dhe mendimin kritik					
2.	Metodat mësimore nxisin mendimin kritik, kreativitetin dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve					
3.	Metoda e bashkëpunimit rrit nivelin e komunikimit midis nxënësve					
4.	Krahasoj arritjet e nxënësve të mi për të parë ndikimin e strategjive dhe metodave të mësimdhënies					
5.	Shfrytëzoj rezultatet e metodës së dialogut për të përmirësuar zhvillimin e aftësive të buta të nxënësit					
6.	Shkolla jonë plotëson kushtet infrastrukturore për aplikimin e metodave mësimore					
7.	Jap të gjithë nxënësve informata kthyesë për të nxënësit e tyre gjatë orës mësimore					
8.	Identifikoj vështirësitë me të cilat ballafaqohen nxënësit gjatë aplikimit të metodave të mësimdhënies përmes informatës kthyesë					
9.	Nxënësit qartësojnë idetë e tyre për qëllimet e të nxënësit dhe mendimin kritik përmes aplikimit të metodave të mësimdhënies					
10.	Metoda demonstrative ndihmon nxënësit më të dobët sepse i jep mundësi të shohin aktivitete praktike më të avancuar					

11.	Nxënësit fitojnë ide më të qarta se si t'i ndihmojnë vetes për t'u përmirësuar përmes komunikimit					
12.	Shprehitë komunikues u ndihmojnë nxënësit të korigjojnë njohuritë e tyre momentale, lëshimet dhe gabimet gjatë të nxënësve					
13.	Nxënësit mësojnë më shumë kur parashtrojnë pyetje më shpesh gjatë përcjelljes së përparimit dhe kontrollimit të të kuptuarit.					
14.	Parashtimi i pyetjeve nxit tek nxënësit të menduarit e nivelit të lartë					
15.	Metodat mësimore nxisin dëshirën dhe përkushtimin e nxënësve si dhe orientojnë ata për arritjen e rezultateve të të nxënësve					